



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi për shqyrtimin nen për nen të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, për grupin e IV-t të dispozitave, pjesa e prokurorisë,(nenet 45 - 56).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Arben Ristani, Oerd Bylykbashi, Jorida Tabaku, Gent Strazimiri dhe Fatmir Mediu.

Mungon:

Eduard Halimi, Spartak Braho.

Të ftuar:

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Në vazhdim të mbledhjes së mëparshme kemi rënë dakord për shqyrtimin e pjesës që ka të bëjë me prokurorinë. Atëherë, kemi nenet që lidhen me prokurorinë (nga neni 45 deri tek neni 55). Kështu që mund të vazhdojmë.

Ka ndonjë gjë në parim?

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Në fakt, meqenëse diskutojmë kapitullin mbi prokurorinë, meqenëse vij nga kjo fushë, duhet të jap edhe kontributin modest lidhur me diskutimin sot të këtyre neneve.

Dua ta nis me nenin 45, që, në fakt, është thelbi i diskutimeve të sotme.

Neni 45, që ndryshon nenin 148 të Kushtetutës, në gjykimin tim ka një objekt rregullimi tepër të gjerë, sepse përfshin themelimin dhe funksionimin kushtetues të sistemit të prokurorisë, themelimin e Prokurorisë së Posaçme, kushtet për të qenë prokuror, kushtet për të qenë prokuror i posaçëm, përgjegjësitë disiplinore dhe mënyrën e largimit të prokurorëve nga sistemi.

Për këto arsye, që në fillim kam mendimin se ky nen duhet të ndahet në disa nene, pa prekur parashikimet që bën ky nen, por për efekt të qartësisë dhe riformulimit të normave sugjeroj që ky nen të ndahet në disa nene, e para.

E dyta, duke parë edhe renditjen dhe radhën e parashikimeve që janë bërë në draftin kushtetues për mënyrën e organizimit të sistemit të drejtësisë penale, them se fill pas parashikimeve që bën neni 45, i cili ndryshon nenin 148 të Kushtetutës, të parashikohen dispozitat në lidhje me Prokurorin e Përgjithshëm, kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm dhe kështu me radhë, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të spostohet pas dispozitave që parashikojnë organizimin dhe funksionimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kjo gjithmonë për sa i përket teknikës legjislative.

Tani, lidhur me argumentet që thashë në lidhje me nenin 45, pse duhet ndarë në disa nene, pa e prekur thelbin e këtij neni, dua të jap edhe argumentet, rast pas rasti, pse duhet bërë një ndarje e tillë.

Vijmë te mënyra e organizimit apo parashikimi i numrit minimal të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Është e nevojshme edhe këtu të kemi diskutime lidhur me faktin nëse duhet parashikuar në Kushtetutë numri minimal i prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme apo duhet t'i lihet ligjit, por, gjithsesi, kur ta marrim nenin 45, paragraf për paragraf, do të bëj edhe propozimet përkatëse.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Ulsi Manja – Gjithsesi, ky nen ka një spektër shumë të gjerë rregullimi. Ndaj propozoj të bëhet ndarja e këtij neni pa prekur parashikimet që janë bërë në të gjitha germet e këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë koment për këtë gjë?

Është riorganizimi i kapitullit dhe riorganizimi i neni për shkak se propozimi, siç e kuptova unë, siç është shkruar nuk të jep paraqitjen e një neni kushtetues, është i gjatë, për ta bërë më të përdorshëm dhe për t'i dhënë frymën dhe formën kushtetuese, është e domosdoshme të bëhet një riformulim.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, besoj që është në linjën e arsytimeve logjike që kemi bërë deri sot, që ka nevojë të ndryshohen.

Fatmir Xhafaj – E mbështesni edhe ju?

Oerd Bylykbashi – Po, ka gjëra që mund të mos jenë këtu, mund të jenë në ligj, por një zhdërvjellësim i dispozitës...

Fatmir Xhafaj – Në rregull, në qoftë se në parim biem dakord, vazhdojmë me nenin 45 atëherë. Besoj që ekspertët nuk kanë ndonjë gjë për këtë çështje.

Jon Smibert - Drafti origjinal ka pasur një nen të veçantë për Prokurorinë e Posaçme. Pra, ka qenë i ndarë në dy, por më pas gjatë negociimeve në dhjetor, një nga përfaqësuesit e grupeve donte të inkorporonim një referencë më të shkurtër mbi Prokurorinë e Posaçme. Komisioni i Venecias u shpreh se kjo ishte e panevojshme, pasi do duhej që të referohej në marrëdhënien që do të ketë Prokuroria e Posaçme me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Kjo rizgjeroi atë seksion. Sigurisht që është e mundur të krijohet një nen i dytë, ashtu siç ka qenë draftuar në fillim. Është në rregull në çdo mënyrë.

Fatmir Xhafaj - Me sa shoh, ka mirëkuptim nga të gjithë për një riformatim të këtij kapitulli për ta bërë më praktik dhe, së dyti, për ta përmbledhur, në mënyrë që të jetë brenda gjuhës sonë kushtetuese dhe natyrës së një neni kushtetues.

Në rregull, faleminderit!

Fillojmë tani konkretisht me nenin 45.

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Ne mendojmë që ky nen të ketë një riformulim të tillë: “Prokuroria është organi shtetëror që organizohet në mënyrë autonome dhe funksionon në mënyrë të pavarur. Ajo ka kompetencë dhe detyrim të ushtrojë veprimtarinë e ndjekjes penale dhe të përfaqësimit të akuzës në gjyq në emër të shtetit. Ligjshmëria e veprimtarisë së prokurorisë i

nënshtrohet kontrollit nga pushteti gjyqësor. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

Struktura organizative e prokurorisë përputhet me atë të gjykatave. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët kanë pavarësi të brendshme dhe i nënshtrohen Kushtetutës, ligjeve dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm”. Ky është formulimi që kemi ne për një paragraf të shkëputur. *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, që të jetë si nen më vete.

Fatmir Xhafaj – A ka mundësi me radhë, ju lutem, se nuk është se...? Secili të shprehet me mikrofon.

Unë nuk e kuptoj këtë. Nenin 48 e përmbledhni në kaq...?

Arben Ristani – Jo, do të vazhdojmë më tutje me një nen tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, se dua ta kuptojmë të gjithë!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, përtej asaj që biem dakord, se ndoshta ka nevojë për ta ndarë dhe ky është formulim për pjesën e parë të asaj që do të jetë neni i parë për seksionin e prokurorisë, janë një seri problemesh të cilat në këndvështrimin tonë nuk janë reflektuar ashtu siç duhet.

Së pari, është e nevojshme, domethënë ka qenë një qëndrim i shprehur edhe më parë në diskutimet politike nga ana jonë, që ne na duhet një organ, i cili është *streamline*, që është i harmonizuar nga brenda, por duke garantuar në mënyrë absolute një autonomi shumë të fortë të Prokurorisë së Posaçme.

Vetë Komisioni i Venecias flet për autonomi të prokurorëve dhe jo për pavarësi, po ashtu Komisioni i Venecias rekomandon autonominë e Prokurorisë së Posaçme. E thënë kjo, duke përcaktuar elementet e domosdoshme dhe të nevojshme në Kushtetutë, që do të garantonin këtë lloj autonomie dhe në asnjë mënyrë nuk mund të anashkalohej nëpërmjet formulimesh ligjore.

Kjo vjen për të kuptuar edhe një strukturë të tërë. Ne kemi një Prokuror të Përgjithshëm, i cili zgjidhet me shumicë të cilësuar në Parlament, por nuk ka në kompetencën e tij...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – ...neni 45 nuk ka të bëjë me Prokurorin e Përgjithshëm.

Oerd Bylykbashi – A mund ta vazhdoj zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Po, vazhdoje, por qëndro brenda nenit për të cilin po flasim!

Oerd Bylykbashi – Besoj se po të më dëgjoni deri në fund, do të kuptohemi. Ajo që po them është se ne na duhet një harmonizim i strukturës së prokurorisë, ku autonomia e fortë do t'i garantojë Prokurorisë së Posaçme një hetim të painfluencueshëm nga prokurori i Përgjithshëm apo nga strukturat e tjera të prokurorisë. Kështu që Prokuroria e Posaçme, do të kishte hapësirën e plotë që të ushtronte hetimin e painfluencuar, qoftë të krimit të organizuar, qoftë të korrupsionit, edhe mbi zyrtarët e lartë.

Sot, duke ndërtuar një strukturë siç e kemi, duke i dhënë Prokurorisë së Posaçme me të drejtë këtë lloj hetimi, këtë lloj fushe të përcaktuar të hetimit, pjesës tjetër të prokurorisë i heqim, ndoshta pjesën më të mprehtë të hetimit dhe jemi dakord të ecim në këtë drejtim.

Nga ana tjetër kemi një Prokuror të Përgjithshëm, i cili zgjidhet me 3/5 nga Parlamenti, pra për kreun e prokurorisë kemi investuar shumë energji politike.

Veç kësaj ka një koncept shumë të qartë: ai është i lidhur me kontrollin dhe me balancat, ku Parlamenti ka një pikë takimi me prokurorinë dhe prokurori është ai që raporton, gjithashtu, për gjendjen e kriminalitetit dhe mënyrën si është ushtruar politika penale. Nëse vazhdohet kështu, do të kishim një situatë, ku prokurori i posaçëm nuk i përgjigjet Parlamentit dhe publikut për pjesët më të rëndësishme të hetimit penal dhe të politikës penale, ndërsa Prokurori i Përgjithshëm do të përgjigjej për pjesët e përgjithshme. Pra, duket sikur po ndërrojmë konceptin në mënyrë themelore. Kështu që do të ishte nevoja që t'i vëmë veshin asaj që thotë Komisioni i Venecias për autonominë, ku Prokurori i Përgjithshëm nuk ka mundësi të influencojë në mënyrë absolute në mënyrën si operon prokuroria e posaçme. Sigurisht, më pas mbeten edhe çështje të tjera. Formulimi aktual për njësinë e posaçme hetimore është vetëm një fjali, e cila pothuajse nuk thotë asgjë nga ajo që është e nevojshme, që është diskutuar dhe besoj se kemi rënë dakord, që Byroja Kombëtare e Hetimit e famshme, do të jetë një njësi, e cila do të jetë në varësi të plotë...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ja se e kam të plotë formulimin këtu, te neni 45:

“Njësia e posaçme hetimore raporton vetëm tek Prokuroria e Posaçme.”

Fatmir Xhafaj – Këto janë çështje që i ka i gjithë kapitulli. Fokusohu!

Oerd Bylykbashi – A biem dakord që është te neni 45 kjo fjali?

Fatmir Xhafaj – Po, është te neni 45 kjo fjali. Si e doni ju?

Oerd Bylykbashi – Këtë po e shtjelloj. Njësia e posaçme hetimore, një instrument kaq i rëndësishëm duhet të jetë pa asnjë lloj ekuivoku në varësinë e Prokurorisë së e Posaçme, edhe në mënyrën si emërohet drejtuesi i saj, i cili s'mund të jetë polic, duhet të jetë

totalisht një strukturë e pavarur. Pavarësia e saj duhet të jetë pjesë e pavarësisë së prokurorisë së posaçme.

Fatmir Xhafaj – Po, e qartë.

Oerd Bylykbashi – E zgjidhim atë, zoti kryetar, por polic, jo.

Atëherë, që ta vazhdoj ne na duhen ato elementë që kur të rregullohet njësia e posaçme hetimore, ligji të mos ta devijojë dhe deformojë nga qëllimi që kemi. Prokurorinë e posaçme, nëse e nxjerrim në luftë me pa shpatën në dorë, nuk kemi bërë gjë, kështu që ta ndajmë këtë gjë për ta rregulluar më mirë.

Gjithashtu, besoj se mbeten ende shqetësimet ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Me durim, do të kuptohemi me njëri-tjetrin. Ne jemi kuptuar edhe për gjëra të tjera, zoti kryetar.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Zoti kryetar edhe unë kam dëshirë që ta mbyllim sa më shpejt, por për gjëra që ndoshta jemi më në marrëveshje.

Çështja që po shtrojmë, është se duket se nuk ka ende një trajtim, siç e ngre shqetësimin Komisioni i Venecias, lidhur me çështjen e kontrollit, të ndërhyrjes në aspektin e privatësisë së këtyre personave. Pra, duket se ka ende gjëra, të cilat mund të çojnë nesër në aspekte problematike, të cilat lidhen edhe me shkelje të të drejtave të personave, përfshirë familjarët, të cilat edhe mund të ma çojnë në problematikën e funksionimit. Kështu që, duhet ta shohim pak me kujdes këtë pjesë.

Një tjetër çështje, është mënyra e zgjedhjes. Ne kemi një dualitet të mënyrës së zgjedhjes. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me shumicë të cilësuar, ndërsa Prokurori i Posaçëm zgjidhet në KLP. Na duhet me këtë mënyrë, siç e kemi ndërtuar, mund të kemi një sistem prokurorie, që është disfunkcional apo në kolezion me njëri-tjetrin. Prokuroria duhet të jetë instrumenti më efikas, që kemi në luftën kundër krimit. Nëse kemi lojë pushtetesh brenda prokurorisë, nuk do të funksionojë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Ta lexojë pjesën e parë të propozimit, zoti Ristani!

Fatmir Mediu – Po vazhdoj unë.

Zoti Ulsi e shtroi që të kemi një kuptim më të qartë të nenit 45. Atë nen e kemi ndarë në 3 nene, ku kemi përcaktuar se ç'është definicioni i Prokurorisë së Përgjithshme, strukturën etj., Prokurori i Përgjithshëm, kriteret dhe kush e emëron Prokurorin e Përgjithshëm dhe më pas, Prokuroria e Posaçme, në një nen më vete.

Nëse do të vazhdojë te ajo që nisi zoti Ristani, ne shtojmë tre nene, në vend të nenit 45, që janë vënë për t'i definuar pak më qartë ato shqetësime, që ngriti zoti Bylykbashi.

Neni tjetër që shtojmë, që fillon me Prokurorin e Përgjithshëm, është:

“1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Kuvendi dhe përzgjidhet nga lista e renditjes së kandidatëve e hartuar nga KLP-ja.

2. Prokurori i Përgjithshëm emërohet me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 7-vjeçare, pa të drejtë riemërimi nga radhët e 5 kandidatëve të renditur më lart në listën e hartuar nga KLP-ja. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave në Kuvend, përsëritet një votim i dytë brenda 7 ditëve nga radhët e dhjetë kandidatëve të kualifikuar më lart. Nëse edhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidati që është renditur i pari nga KLP-ja, sipas parimit të meritokracisë, konsiderohet i emëruar.

3. Prokurori i Përgjithshëm duhet të jetë me shtetësi shqiptare dhe përzgjidhet nga radhët e juristëve me aftësi më të larta profesionale. Ai duhet të ketë njohuri të thella të veprimtarisë publike dhe të ndjekjes penale, si dhe të paktën 13 vjet përvojë të spikatur pune në profesion. Prokurori i Përgjithshëm duhet të gëzojë integritetin më të lartë moral dhe profesional...”

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Unë po e lexoj, siç i kemi organizuar ne. Ne po bëjmë një propozim, të cilin ju lutem ta dëgjoni. Ne po përpiqemi që në vend të nenit 45, të fusim 3 nene me këtë renditje, që po propozojmë.

“... Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në organe publike apo në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit.

Procedura e përzgjedhjes dhe e emërimit të prokurorit të Përgjithshëm garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis kandidatëve, vlerësimin krahasimor të përmbushjes së kritereve, transparencës dhe standardeve të tjera të një procesi të rregullt ligjor. Rregullat më të detajuara për vlerësimin e kushteve dhe të kritereve, si dhe procedura e kandidimit të zgjedhjes dhe të emërimit, përcaktohen me ligj.”

Pas nenit 149, shtohen nenet: 149/1, 149/2, 149/3, 149/4, 149/5, 149/6 me përmbajtje si vijon, për sa u përket kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm:

Zoti Majko, po jua them edhe një herë, se te neni 148 kemi edhe Prokurorinë e Posaçme, edhe prokurorinë si definicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Atëherë, unë po e lexoj propozimin tonë, se herën e parë na thatë t'ju themi se çfarë propozimi kemi. Unë po ju them, se çfarë propozimi kemi.

Unë vlerësoj mendimin e ekspertëve të huaj dhe të vendit që na kanë ndihmuar për të sjellë këtë.

Po e lexoj duke u përpjekur ta kuptoj edhe vetë dhe më pas, do t'ju dëgjoj edhe ju me vëmendje.

“Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: Përfaqëson prokurorinë në Gjykatën e lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rasteve, kur përfaqësimi bëhet nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Bën dhe nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët me përjashtim të prokurorit të prokurorisë së posaçme. Udhëzimet e përgjithshme nxirren për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë së prokurorisë, në zbatimin e një politike të drejtë penale në luftën kundër kriminalitetit, si dhe për të siguruar zbatimin uniform të ligjit nga prokurorët.

c. Kontrollon zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të miratuara prej tij dhe zbatimin e politikës penale në luftën ndaj kriminalitetit, me përjashtim të prokurorëve të prokurorisë së posaçme.

ç. Shqyrton ankesat ndaj prokurorëve, kontrollon veprimtarinë e tyre të të gjitha niveleve dhe kur është rasti, paraqet në KLP kërkesën për procedim disiplinor të tyre, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.

d. Drejton, kontrollon dhe kujdeset për administrimin e zyrave të prokurorisë dhe për shërbimin e administratës së tyre, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme.

dh. Mbikëqyr trajnimin profesional të administratës së prokurorisë me përjashtim të asaj të Prokurorisë së Posaçme.

e. Propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme.

ë. Raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, duke informuar të paktën një herë në vit publikun dhe Kuvendin për nevojat e organit të prokurorisë.

f. Ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Prokurori i Përgjithshëm nxit efikasitetin dhe cilësinë e veprimtarisë së prokurorisë duke bërë planifikim strategjik dhe strukturor të organit të prokurorisë, me përjashtim të Prokurorisë së Posaçme. Ai merr masa për të forcuar besimin publik te organi i prokurorisë duke vlerësuar cilësinë e veprimtarisë së prokurorisë, si dhe duke i kërkuar autoritetit shtetëror kompetenca për marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë e ndjekjes penale.”

Më pas janë edhe të tjerat, por mbase kolegët e mi mund të shtojnë ndonjë gjë.

Fatmir Xhafaj – E lexove deri në fund?

Fatmir Mediu - Jo, thashë vetëm këto, 2, 3 e të tjera, por mund t’jua lë edhe me shkrim.

Fatmir Xhafaj – Jo, e lexuat deri në fund atë që kishit, sepse më thatë se kishit diçka për të lexuar.

Fatmir Mediu - Këtë thashë.

Fatmir Xhafaj – Po shqyrtojmë nenin e prokurorisë. Ti thua: do ta dëgjoni sipas versionit tim. Marrim nenin që është këtu, sepse ne po shqyrtojmë këtë projekt.

Fatmir Mediu - Për këtë projekt po flas edhe unë. Jemi përpjekur që nenin 45 ta ndajmë në nene të tjera.

Fatmir Xhafaj – Nuk është i ndarë, zoti Mediu. Neni 45 nuk ka të bëjë me kompetencat e prokurorit.

Fatmir Mediu – Ka të bëjë me Prokurorinë e Përgjithshme.

Fatmir Xhafaj – Po, me Prokurorinë e Përgjithshme. Nuk ka të bëjë.

Fatmir Mediu – Ke edhe Prokurorinë e Posaçme brenda, apo jo?

Fatmir Xhafaj – E ke nen më vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord.

Fatmir Mediu – “Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet pranë Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë e të tjera”. Këto ne i kemi ndarë. Është kaq e thjeshtë. Po, për këtë nen po flasim.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por kalove nenin...

(Diskutime pa mikrofon).

Edhe një herë, merren nenet me radhë dhe thuhet që në fillim fare. Kemi gjë për... Jo, duhet të bëjmë një ndarje të re të statutit. Biem dakord? Po, dakord. Jeni dakord për këtë gjë? Po, dhe mbarojmë te pjesa e dytë. Pastaj thua: nenin 1, do ta ndajmë? Si do ta ndajmë? Atëherë do të kalojmë nenin...

Fatmir Mediu – Këtë thamë.

Fatmir Xhafaj – Pastaj thua neni 52 kalon neni 2, neni 53 kalon neni 3 dhe kështu bëhet.

Fatmir Mediu – Këtë thashë.

Fatmir Xhafaj – Sepse bëhet kakofoni.

Fatmir Mediu –Thashë: formulimi i kapitullit dhe i neneve të veçanta. Ju thoni se neni 45 flet vetëm për prokurorinë, por nuk është kështu, sepse e lexojmë, ja ku e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edhe një herë fare thjesht. Po e përsëris shkurt: ne kemi menduar për ta riorganizuar kapitullin me nenet përkatëse, për t'i definuar pak më qartë. Doni të bëni debat për një çështje që nuk ka nevojë për debat? Vlen, apo nuk vlen shtesa apo gjykimi që ka për një nen të caktuar kjo.

Oerd Bylykbashi – Më falni, për procedurë.

Ne kemi vullnetin për të ecur përpara, por këto janë kundërshtimet tona. Këtu nuk jemi përpara një mësimi didaktik, ku mund të na thuhet se si mendojmë ne të flasim. Nuk jemi në shkollë, jemi komision parlamentar dhe kemi qëndrimet tona. Doni t'ju lexoj çështje të tjera brenda këtij neni, që janë problematike jo vetëm në aspektin teknik, por edhe funksional?

Fatmir Xhafaj –E hedhim në votë se cili është qëndrimi?

Oerd Bylykbashi – E para, këtu nuk ka votë.

Fatmir Xhafaj – Dakord atëherë.

Si nuk ka votë? Ky është komision.

Oerd Bylykbashi – Në qoftë se këtu votohet, e mbyllim komisionin.

Fatmir Xhafaj –Pse, çfarë e di ti këtë?

Oerd Bylykbashi – Kryetar, po ju them: mos e çoni me votim! Pozicionet tona janë pozicionet tona.

Fatmir Xhafaj – Cilat pozicione, zotëri? Po flasim për një projekt konkret.

Oerd Bylykbashi – Do ta gjejmë zgjidhjen bashkë.

Fatmir Xhafaj - Kur flitet për një gjë, unë të kuptoj shumë mirë, të kanë dhënë një gjë përpara dhe thua se do ta lexosh, dakord, nuk ka asnjë gjë të keqe, secili ka mënyrën e vetë të prezantimit të gjësë, këtu nuk të ndërhyj. Por, kur flasim për logjikën e diskutimit, këtu të ndërhyj. Ka një logjikë diskutimi. Flitet në parim...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zonja Hysi, ka mundësi, ju lutem?

Flitet për një logjikë debati në komision. Logjika është: flitet në parim për të gjithë kapitullin, biem dakord. Ramë dakord se ka nevojë për një strukturë dhe mbyllet këtu debati. Pastaj kalohet dhe thuhet: neni 45 do ta ndajmë në këtë gjë, do të kalojë neni i prokurorisë, e zhvendosim dhe bëjmë debat për Prokurorin e Përgjithshëm. Jam dakord, ta bëjmë debatin

për dy nenet e prokurorit të Përgjithshëm, por janë dy nene këtu, nuk është se nuk janë. Kjo është logjika e gjësë. Megjithatë, dakord.

Zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja – Për të qenë korrekt, nëse ka një kapitull të këtij drafti, të këtij projekti kushtetues, për të cilin kemi rënë dakord që në fillim, ka qenë organizimi i sistemit të drejtësisë penale. Nuk e kuptoj pse duhet të bëjmë diskutime në parim, sepse kemi rënë dakord që ditën e parë për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë.

Unë e thashë në fillim që neni 45, i cili ndryshon nenin 148 të Kushtetutës ka nevojë të ndahet në disa nene, pasi në të njëjtin nen është parashikuar funksioni kushtetues i sistemit të prokurorisë, është parashikuar themelimi i Prokurorisë së Posaçme, janë parashikuar kushtet për të qenë prokuror dhe kushtet për të qenë prokuror i Prokurorisë së Posaçme, janë parashikuar përgjegjësitë disiplinore dhe mënyra e largimit të prokurorëve nga sistemi. Pra, është një nen shumë i gjerë.

Unë propozoj që propozimet e bëra në këtë nen të parashikohen në pesë nene të tjera, gjithmonë për efekt të kuptimit të drejtë dhe të një teknike të pastër kushtetuese dhe legjislative. Propozoj të kemi një nen 45, ku të parashikohen funksionet kushtetuese të prokurorisë, si më poshtë:

“Neni 45.

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur, që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale.

3. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor. Pavarësia e brendshme e prokurorëve në zbatim të funksioneve për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq respektohet sipas ligjit.” Ky është një propozim për funksionin kushtetues të prokurorisë.

Të ketë një nen tjetër 45/1 që po bën parashikimin e themelimit të Prokurorisë së Posaçme, sepse kemi rënë dakord, dhe unë...

(Diskutime pa mikrofon).

Jo, unë bëj këtë propozim.

Fatmir Xhafaj – Ajo që bëtë ju, është se kaluat dispozitat e Prokurorit të Përgjithshëm te neni 45.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Nen tjetër, 45/1, dakord. Është 45, ju e bëtë te neni 46 prokurorin. Konceptin kushtetues të organit e dha zoti Ristani, apo jo? Pastaj ju e zhvendosët Prokurorin e Përgjithshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, kjo ishte. Atë që të kërkova unë ishte: do ta kalojmë këtë kështu? Po, për një moment do ta kalojmë, nuk ka rëndësi. Ne e zhvendosim në fund vendosjen logjike. Flasin për Prokurorin e Përgjithshëm dhe e mbaron debatin për prokurorin. E keni të qartë?

Arben Ristani – Të bëhemi konstruktivë. Ramë dakord që nenin do ta ndajmë, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Po, edhe ai po bën një ndarje të nenit.

Arben Ristani – Do të kemi konceptin kushtetues të prokurorisë. Unë mendoj të fillojmë me Prokurorin e Përgjithshëm dhe të vazhdojmë me Prokurorinë e Posaçme.

Fatmir Xhafaj – Dakord, këtë ju kërkova edhe unë, apo jo?

Arben Ristani – Kjo është më logjike, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Atëherë, i nderuar koleg, që më solle në emërues të përbashkët, ne mund ta shqyrtojmë, nuk ka rëndësi si e vendosim, por ka rëndësi që do të bëjmë një ndarje të nenit. Ai po bën një ndarje të nenit. Më pas do të diskutojmë Prokurorinë e Posaçme dhe, kur të vijmë te Prokurori i Përgjithshëm, do të diskutojmë.

Dakord, zoti Mediu tha me të drejtë: “Unë kam një gjykim se si do të jenë kompetencat”. Cili është koncepti për Prokurorin e Përgjithshëm, vendi që zë Prokurori i Përgjithshëm, zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm dhe kompetencat e tij? Le ta marrë këtë dhe më pas e vendosim se ku do ta vendosim, te neni 46, apo te neni 47, është një çështje tjetër.

Fatmir Mediu – Në qoftë se flasim dhe respektojmë njëri-tjetrin, pavarësisht nga dijet, ne jemi anëtarë të komisionit dhe secili ka të drejtë të flasë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Fatmir Mediu – Unë i dëgjova me vëmendje kolegët Manja, Ristani dhe Bylykbashi kur folën. Zoti Manja hodhi idenë sesi duhet riformuluar për nga pikëpamja e kushtetutshmërisë që të jetë më funksionale, që përputhet edhe me qëndrimin tonë. Zoti Ristani ishte më konkret për nenin përkatës. Dakord? Zoti Bylykbashi ngriti shqetësimin që ne kemi për të qenë sa më funksionalë në sistemin e prokurorisë. Ajo që thashë unë është se ne po përpiqemi ta detajojmë në nene të tjera dhe thashë që janë këto nenet shtese dhe nuk thashë te neni 45. Madje i kam përmendur, neni 148, sipas Kushtetutës që kemi ne, neni 149, 149/1, 149/2 e kështu me radhë, pra ndarjen në nene. Meqenëse herën e parë ju këtu patët

shqetësimin pse diskutonim në përgjithësi, unë u përpoqa ta them nenin siç e kemi shkruar ne për ta debatuar me njëri-tjetrin. Në qoftë se vlen për ta bërë këtë diskutim, mirë. Pa dyshim që është rationale të mbarojmë atë që diskutuan zoti Ristani dhe zoti Manja, pastaj të vazhdohet me të tjerat. Nuk kam asnjë vërejtje. Çështja është thjesht për të vazhduar procedurën. Ta dëgjojmë njëri-tjetrin pa i bërë komente.

Oerd Bylykbashi – Në konceptin e asaj që parashtrua ne në fillim, që prokuroria duhet të ketë një mënyrë funksionale organizimi, nga kokë në fund, që të jetë funksionale dhe efikase në punë, na duhet ta konceptojmë edhe mënyrën si shkruhet këtu, se nesër do ta marrë Gjykata Kushtetuese këtë nen dhe do ta interpretojë, ku ta di unë për çfarë konflikti. Nuk mundet që neni 45, pasi flet për prokurorinë, të flasë dhe ta stërhollojë të gjithë gjënë për Prokurorinë e Posaçme, sikur kjo është më e rëndësishmja. Neni për Prokurorin e Përgjithshëm është në fund. Jo, e do logjika të ketë një linjë nga fillimi në fund. Nëse duam ta bëjmë Prokurorinë e Posaçme një super prokurori, e diskutojmë, por kur t'i vijë radha, për rrjedhojë edhe propozimi që bëjmë ne ndjek këtë logjikë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ristani, biem dakord bashkë që të kuptohemi për një gjë: e ndajmë nenin 45, pastaj se ku e vendosim Prokurorinë e Përgjithshme, mund ta vendosim menjëherë pas konceptit kushtetues të prokurorisë, por i shqyrtojmë një herë, pastaj rivendosjen, sistemimin në strukturë e bëjmë si të jetë më e mira. A biem dakord?

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – E bëjmë edhe ashtu, por kam hall se duhet...

Fatmir Xhafaj – Nuk e ndjekim dot, se i kemi përpara nenet. A më kupton çfarë po them? Ndjekim nenet...

(Mungesë incizimi.)

Edhe njëherë: për ta ndarë nenin 45 në tre koncepte. Të dy keni dhënë konceptin mbi organizimin e institucioneve të prokurorisë, tani vazhdojmë me Prokurorinë e Posaçme siç e keni ju.

Ulsi Manja - Për t'i shkuar logjikës, edhe unë jam dakord. Le të jetë koncepti i Prokurorisë së Posaçme para dhe i Prokurorit të Përgjithshëm pas, unë fill pas funksioneve kushtetuese të prokurorisë kam bërë një riformulim të nenit 45/1 për Prokurorinë e Posaçme, sepse është organ i ri kushtetues dhe nuk është se vjen para Prokurorit të Përgjithshëm se është super institucion.

Doni ta zhvendosim Prokurorinë e Përgjithshme? Për mua nuk është problem, por meqenëse është organi i ri kushtetues unë kam thënë se pas nenit 45 të kemi 45/1 me këtë formulim: “Pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit, krimin

të organizuar dhe çështjeve penale kundër funksionarëve të lartë, funksionon Prokuroria e Posaçme për ndjekjen penale të këtyre veprave”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kaloje Prokurorin e Përgjithshëm para, nuk ka problem!

Pika 2: “Pranë Prokurorisë së Posaçme për ndjekjen e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale kundër funksionarëve të lartë, funksionon Njësia e Posaçme Hetimore për hetimin e këtyre veprave penale”.

Pika 3: “Prokuroria e Posaçme për ndjekjen penale dhe Njësia e Posaçme Hetimore për hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale kundër funksionarëve të lartë, janë të pavarura nga prokurori i Përgjithshëm lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre për ushtrimin e ndjekjes penale , hetimin dhe përfaqësimin e akuzës”.

Pra, ky është formulimi që unë propozoj për themelimin e Prokurorisë së Posaçme. As më shumë dhe as më pak është një riformulim i pikës 2 të nenit 45, paragrafi “a” i grupuar në tri nene.

Jo, neni 45 ka edhe të tjera. Direkt pas formulimit që unë dhashë për Prokurorinë e Posaçme duhet të vijë kushtet për qenë prokuror, sepse është shumë normale, kushtet për të qenë prokuror në Republikën e Shqipërisë, nuk ka rëndësi prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme apo prokuror në hierarkinë e Prokurorisë së Përgjithshme, janë të njëjta. Po të shohësh frymën e parashikimeve kushtet për të qenë prokuror janë të njëjta.

Unë propozoj edhe një nen 45/2, ku them që pas nenit 148/a të shtohet neni 148/b me këtë përmbajtje: “Prokurorë mund të jenë vetëm shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre sipas ligjit”.

“Kandidatët përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe publike, që siguron përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar dhe me integritet të lartë moral dhe profesional. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve të parashikohen me ligj”.

Unë për nenin 45 kam edhe dy propozime të tjera, por kur të vijmë te kapitulli përkatës do t’i bëj, që lidhen me kushtet për të qenë prokuror në Prokurorinë e Posaçme dhe me masat disiplinore të prokurorëve. Por kur të vij te kapitulli përkatës i draftit do t’i them edhe propozimet.

Arben Ristani – Për ne Prokuroria e Posaçme është e ndërtuar pranë gjykatës, siç e thashë. Duke qenë se ne objektin e punës së Gjykatës së Posaçme e kemi formatuar atje, te gjykatat, i bie që edhe prokuroria të ketë të njëjtin objekt pune.

Fatmir Xhafaj – Ka të njëjtën kompetencë.

Arben Ristani – Për ne formulohet kështu: “Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Apelit rregullohet me ligj të veçantë dhe është e pavarur nga prokurori i Përgjithshëm. Ajo e ushtron veprimtarinë për ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës sipas kompetencës së Gjykatës Penale të Posaçme”.

“Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi funksionale dhe administrative vetëm të Prokurorisë së Posaçme dhe kryen funksionet e Policisë Gjyqësore në kuadër të veprimtarisë së kësaj prokurorie. Ajo drejtohet dhe kontrollohet nga Prokuroria e Posaçme. Rregullat më të detajuara për organizimin dhe funksionimin e saj caktohen me ligj.”

Ne i kemi në një nen edhe pjesët e tjera.

“Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos për emërimin e drejtuesit dhe të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Ndërsa për shkarkimin e tyre nga detyra vendos me 2/3-at e anëtarëve.”

“Prokuroria e Posaçme duhet të ketë të paktën 10 prokurorë me mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme me mandat 3-vjeçar, pa të drejtë riemërimi sipas ligjit. Në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit prokurorët rikthehen në vendet e mëparshme të punës”.

“Kriteret e tjera dhe procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesit dhe të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme parashikohen me ligj. Drejtuesit dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, oficerët e Njesisë së Posaçme Hetimore, si dhe administrata e tyre përpara emërimit duhet të kalojnë me sukses procesin e verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk mund të emërojë asnjë prokuror të Prokurorisë së Posaçme pa marrë pëlqimin e tij dhe të familjarëve të afërm për kontrolle periodike të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve personale sipas ligjit. Oficerët e hetimit dhe punonjësit e administratës i nënshtrohen gjithashtu, kontrollit periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve personale sipas ligjit. Telekomunikimet personale të familjarëve të afërt, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin, mund të kontrollohen vetëm me vendim gjyqësor.

Në këtë formë mendojmë të përmblihet e gjithë ajo që ka të bëjë me këtë nen.

Fatmir Xhafaj - Logjika që kuptoj unë, që duhet t'i kuptojnë të gjithë dhe që të biem dakord është: të ndajmë nenin 45 në disa nene, në mënyrë që të japim definicionin kushtetues të prokurorisë të institucionit të prokurorisë së shtetit.

Së dyti, të ndajmë Prokurorinë e Posaçme, në mënyrën se si themelohet dhe si formohet; të ndajmë Prokurorin e Përgjithshëm, se ku e vendosim, është çështje tjetër; të

ndajmë kontrollin për emërimin e prokurorëve, mënyrën se si formohen Prokuroria e Posaçme, Njësia e Posaçme Hetimore e të tjerë.

Dakord? Kjo është logjika? Në rregull!

Pak a shumë, është neni që është këtu, me disa ndryshime, thjesht është një rindarje brendapërbrenda. Të ndajmë çështjen se kush është prokuror, mua më duket e drejtë ndarja që bëri Ulsi, pra të ndajmë statusin e prokurorit dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve si nen me vete.

Zoti Ristani?

Arben Ristani - Në rregull!

Fatmir Xhafaj - Për këtë ndarje, duke qenë se u dhanë parashikimet përkatëse, ka ndonjëri shtesë?

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu - Unë mendoj se në pikëpamjen e formatimit kushtetues i qëndroj faktit që ne duhet të ndjekim hierarkinë.

Fatmir Xhafaj – E thamë këtë.

Fatmir Mediu - Në rregull, por definicionin e prokurorisë e kaluam te Prokuroria e Posaçme, në një kohë që sipas gjykimit tonë duhet kaluar te Prokurori i Përgjithshëm dhe më pas me radhë.

Fatmir Xhafaj - Unë besoj se u kuptuam për këtë gjë. Megjithatë, jam dakord.

Zoti Bylykbashi, keni diçka për të thënë për këtë gjë që po diskutojmë?

Oerd Bylykbashi - Ju thatë që po e organizojmë, por, në fakt, organizimi që bëjmë ne, besoj se të njëjtën gjë do të bënit edhe ju, në logjikë është jo vetëm çështje estetike se ku rri njëra apo tjetra, pra është koncept logjik edhe për shkak se ne besojmë se ndryshimet tona sjellin një seri përmirësimesh, që, ndoshta, edhe ju mund të arrini në të njëjtat konkluzione me ne, ose mund t'i avanconi. Për shembull, në draftin aktual thuhet: “Prokuroria e Posaçme rregullohet me ligj”, ndërkohë ne po e parashikojmë si organ kushtetues.

Së dyti, ka një problematikë në lidhje me BKH-në, ose me Njësinë e Posaçme Hetimore. Thjesht e përmendur, nuk do të na mjaftonte, sepse, duke ia deleguar më pas të gjithë ligjit, rreziku është i madh që ne të devijojmë nëpërmjet ligjit. Supozojmë se e devijojmë të gjithë bashkë, ose mund të mos biem dakord. Pse? Sepse Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka thënë: “Për të qenë një organ kushtetues, nuk mjafton vetëm përmendja e organit, por duhet që të parashikohen dhe disa kompetenca”. Fakti që vetëm përmendet aty, është i pamjaftueshëm dhe kjo është në logjikën tonë, ashtu siç kemi ecur më

tej. Ka çështje që lidhen me aspekte, të cilat janë të paqarta për mënyrën se si e ka drafti aktual dhe ne mendojmë se do të biem dakord dhe do t'i rregullojmë.

Në lidhje me Prokurorinë e Posaçme, thënia “funksionojmë pranë gjykatave të posaçme” nuk mjafton për të përcaktuar mënyrën e organizimit dhe centralizimin apo jo të këtij institucioni, kështu që mendojmë se duhet ta detajojmë më tej. Pra, nuk është vetëm çështje organizimi.

Nuk po i listoj të gjitha momentet, por mendojmë se me propozimet që do të bëjmë, rregullojmë strukturën në një linjë logjike dhe në një lloj hierarkie dhe përmirësojmë ato elemente për të qenë një organ kushtetues.

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, neni 45 përmban 5 probleme të ndryshme. Përveç atyre që thanë kolegët, kam dy shtesa për rekord.

Së pari, do të dalë si nen me vete edhe rasti kur prokurori mund të largohet nga detyra, sepse në Kushtetutë rastet e përgjegjësisë disiplinore dhe rastet e largimit janë nene më vete.

Së dyti, lidhur me Prokurorinë e Posaçme, në fakt, në Kushtetutë ne parashikojmë vetëm dy nene: neni i parë që do të tregojë infrastrukturën e gjykatave të posaçme dhe të njësisive të posaçme; meqenëse kanë një titull të gjatë, mund ta bëjmë Kushtetutën më të lexueshme dhe më të thjeshtë.

Neni i dytë, pavarësisht se ku do ta vendosim si renditje, duhet të përmbajë të paktën 4 elemente shumë të rëndësishme, që duhet të jenë në Kushtetutë.

Së pari, sa i gjatë do të jetë mandati i prokurorëve? Ne kemi thënë që ky mandat do të jetë 9-vjeçar.

Së dyti, sa të gjatë do ta kenë mandatin drejtuesit e prokurorive? 3- vjeçar? Pyetja, që do të shtroja për ekspertët, është: drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme do të ketë një mandat 3-vjeçar pa të drejtë riemërimi apo me të drejtë riemërimi, sepse në projekt është sjellë pa të drejtë riemërimi?

Së treti, në Kushtetutë duhet të jenë patjetër rastet se me sa vota duhet të shkarkohet para përfundimit të mandatit drejtuesi dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme. Kjo duhet të jetë edhe te paragrafi 4. Kush duhet të jetë në Kushtetutë? Duhet të jetë pikërisht kufizimi i të drejtave të tyre për shkak të verifikimit të pasurisë, përveç kontrollit periodik që do t'u bëhet llogarive bankare, telekomunikimeve personale dhe familjare. Pjesa tjetër është shumë mirë në ligj.

Gjithashtu, nga ana e teknikës legislative nëse ne do t'i redaktojmë fjalitë, mendoj se këto dy nene do të dalin më të përmbledhura, pa dashur të përsërisim vazhdimisht emërtimin e kësaj prokurorie, sepse titulli po vihet në krye dhe e sqarojmë më së miri këtë gjë.

Pyetja që kam për ekspertët është : mandati i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të jetë 3-vjeçar, pa të drejtë riemërimi, apo me të drejtë riemërimi?

Fatmir Xhafaj - Zoti Majko, kishit diçka?

Pandeli Majko - Unë do të përkrah atë çfarë tha kolegu Manja, por mendoj se që në fillim duhet të ndajmë diçka për sa i përket çështjes së centralizimit, se e dëgjova nga kolegët. Nuk do të kemi më Prokurorin e Përgjithshëm që kemi pasur, por do të kemi të paktën dy institucione të reja, të cilat nuk mund të funksionojnë më me të njëjtën teknologji centralizimi që ka ekzistuar me prokurorin e Përgjithshëm. Kemi Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili është garanti i cilësisë dhe i procedurës, do të kemi edhe Prokurorinë e Posaçme, që, në fakt, është Prokuroria e Lartë, nëse mund ta quajmë kështu, sepse do të hetojë duke filluar nga Presidenti dhe të gjithë me radhë. Prandaj, mendoj se nuk ka ndonjë problem shumë të madh. Megjithatë, në parim bashkohem me mendimin kolegëve që mund të ketë një renditje për sa i përket strukturës së neneve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Keni diçka për të shtuar për nenin 45?

Arben Ristani - Siç e tha edhe zonja Hysi, brenda nenit 45 duhet të jenë edhe emërimet e prokurorëve, edhe pjesa e disiplinës.

Fatmir Xhafaj - Po është në pikat 3 dhe 5 të nenit ekzistues, ku thjesht do të riorganizohen si nene më vete për të qenë më koncizë.

Arben Ristani - Këto pika do të dalin si nene më vete.

Fatmir Xhafaj - Duhet të bëhet vetëm ndryshimi, por këtë gjë mund ta sqarojë zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Te pika 5 e draftit thuhet: "Prokurorët mbajnë përgjegjësi disiplinore sipas procedurës së rregulluar me ligj. Prokurori nuk mund të largohet nga detyra përveç rasteve kur: i garantohet qëndrimi në detyrë, por gjithçka më sipër flet për përgjegjësi disiplinore, që do të thotë se, kur prokurori mbush moshën e pensionit dhe jep dorëheqjen, nuk janë momente disiplinimi. Nëse largimin do ta shohim si moment disiplinimi, atëherë këtu kemi një konflikt logjik midis të dyjave. Nëse bëhet fjalë për mbarimin para kohe të funksionit, disiplinim apo jo është një gjë tjetër, por duhet të bëjmë kujdes, në mënyrë që kjo

të jetë e qartë. Duhet të jenë vetëm kushtet e disiplinimit. Nëse është disiplinim ose duhet të ndryshohet, terminologjia dhe kjo është pastaj pjesa e riorganizimit si nen më vete dhe besoj se për këtë biem dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se jemi të qartë, sepse, pak a shumë, u dhanë të gjitha mendimet. Qartësia është ende larg, por tani dimë, pak a shumë, në thelb se cilat janë propozimet konkrete për këtë gjë.

Atëherë, meqenëse e mbyllëm të gjithë diskutimin lidhur me nenin 45, për mënyrën se si e mendon secili dhe pak a shumë biem dakord për tërësinë, diferencat do të shihen gjatë mënyrës se si do t'i formulojnë ekspertët.

Besoj se zoti Smibert, duhet të ketë një koment për gjithë këtë diskutim.

Jon Smibert - Doja të theksoja se kjo është çfarë ju do të shkruani. Rainer dhe unë nuk do të jemi arbitrit se si do të jetë. Shpresoj që produkti final të jetë i qartë në lidhje me përzgjedhjen e Prokurorit të Posaçëm dhe kjo është diçka që Komisioni i Venecias do dëshironte të shikonte. Mandati trevjeçar, pa të drejtë riemërimi ka pasur qëllim rotacionin e personave, pasi mund të shikohej si një pozicion i fuqishëm, emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe nuk dëshironim që të bëhej mbret në rolin e tij. Mendoj se është e pranueshme të jetë e ndarë në disa pjesë, për sa kohë mbetet e qartë marrëdhënia midis këtyre organeve, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, për sa kohë që këto gjëra janë të qarta dhe të reflektuara në projektin final.

Në lidhje me pyetjen se përse ka 10 prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, për një mandat 9 vjeçar, i cili mund të zgjatet nëse shikohet e arsyeshme, arsyeja për këtë është se duke qenë se është një Prokurori që do të ndjekë funksionarë të lartë me pushtet dhe mund të ndodhë që mund të limitohet në dy-tre njerëz nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kjo do ta bënte një organ jo funksional. Menduam numrin 10, duke qenë se edhe disa Prokurori të Posaçme të rajonit e kanë nisur me këtë numër dhe më pas u shtuan sipas nevojave. Mund të ishte në ligj, por ishte diçka që u ngrit disa herë dhe menduam se mund të reflektohet.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim diskutimin me 45-ën, mënyrën si e shohim dhe mënyrën si do ta trajtojmë atë.

Jam shumë i kënaqur që edhe eksperti, që ka punuar me shtesat me këtë projekt, me draftin e rishikuar, është dakord. Edhe kjo është pozitive.

Vazhdojmë me nenin 46. Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me nenin 46, i cili shton nenin 48/a, ku flitet për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sugjerojmë disa përmirësime në të njëjtën frymë që bëmë edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor, për të pasur një unifikim të strukturës së nenit, por njëkohësisht edhe të terminologjisë.

Në radhë të parë, përshtypja ime është se ky nen është shumë i gjerë për të qenë në Kushtetutë kaq i detajuar dhe me kaq sqarime. Për të qenë më e qartë, po i marr paragrafët një nga një.

Lidhur me paragrafin e parë, i cili përcakton rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk kam asnjë koment nga projekti i paraqitur nga ekspertët e nivelit të lartë.

Lidhur me paragrafin e dytë, i cili tregon përbërjen e këtij këshilli, që do të përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë, nuk kam asnjë koment. Është korrekte.

Në paragrafin e tretë ka vetëm një ndryshim të terminologjisë, për të theksuar që anëtarët prokurorë zgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional. Pjesa tjetër e fjalisë mbetet ashtu siç është.

Gjithashtu, edhe vazhdimi i këtij paragrafi është korrekt, sipas projektit të paraqitur nga ekspertët e nivelit të lartë dhe shtesat që kanë bërë ekspertët e huaj.

Lidhur me paragrafin e katërt kam disa komente dhe formulime.

E para, në këtë paragraf përcaktohet se cili do t'i propozojë anëtarët joprokurorë. Jam dakord me pluralizmin që duhet ta karakterizojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por përsëri edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sikurse për Këshillin e Lartë Gjyqësor, kam një pyetje për ekspertët.

Pyetja është: A do të vazhdojmë të kemi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë përfaqësues nga radhët e noterëve dhe nga shoqëria civile? Nëse ju mendoni dhe kam parasysh atë çfarë ju keni thënë gjatë gjithë diskutimit në parim, që përzgjedhja nga shoqëria civile është e vështirë, për shkak të mënyrës së organizimit të tyre, atëherë do të sugjeroja që përfaqësuesin e shoqërisë civile, i cili në projekt propozoi të jetë me një anëtar, t'i kalojë Shkollës së Magjistraturës, pra, trupës pedagogjike jo gjyqtarë ose jo prokurorë.

Njëkohësisht, nëse mendoni që nga radhët e noterëve nuk duhet të ketë anëtarë, kjo kandidaturë t'i shtohet trupës pedagogjike të drejtësisë. Kjo është një pyetje, por, njëkohësisht, edhe një sugjerim që bëra.

Lidhur me pjesën tjetër të paragrafit 4 të këtij neni nuk kam ndonjë koment me përjashtim të zëvendësimit në fjalinë e dytë të fjalës nga “organizma”, në “organe përkatëse”.

Pra, të themi “Për çdo vend vakant organet propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi tre kandidatë të përzgjedhur sipas një procedure transparente dhe publike”. Dhe më pas vazhdon: “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit.”

Lidhur me paragrafin e pestë, këtu kam dy probleme ose dy çështje që dua të diskutoj. Është në frymën e KLGJ-së, por për rekorde për të qëndruar duhet thënë si do të formulohet.

E para, mendoj se ky paragraf duhet riformuluar, të jetë më i përmbledhur dhe shumë elemente të procedurës të kalojnë në ligj meqenëse ndryshimet kushtetuese do të vijnë së bashku me paketën e ligjeve.

E dyta, sugjerojmë që Kuvendi të votojë brenda listës dy herë, listës së parë me argumentin, që shpesh mungesa e konsensusit nuk arrihet jo se kandidatët e paraqitur nga organet propozuese nuk janë të mirë, por nuk gjejnë konsensus politik. Prandaj sugjeroj që Kuvendit t’i jepet mundësia që brenda 7 ditëve, nga data e votimit të parë, ku nuk është arritur të përzgjidhet një kandidat, të rivotohet lista e parë. Pra, të mos ketë një listë tjetër, e cila si rregull vjen më e dobët se propozimet e para dhe më pas nëse në votimin e dytë nuk arrihet shumica, përzgjedhja, atëherë të konsiderohet i emëruar kandidati i renditur i pari në listat përkatëse nga këshilli i emërimeve.

Kështu që sugjeroj që paragrafi i pestë të lexohet si më poshtë: “Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë nuk arrihet shumica prej 3/5, Kuvendi voton përsëri brenda 7 ditëve nga data e votimit të parë. Në rast se shumica prej 3/5 nuk arrihet as në votimin e dytë, do të konsiderohen të emëruar kandidatët e renditur të parët nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.”

Lidhur me paragrafin e gjashtë të ligjit do të sugjeroja të qëndrojë vetëm fjalia e parë dhe pjesa e dytë të lihet në ligj, zoti kryetar, sepse është shumë e detajuar dhe ne mund të kemi vetëm një riformulim të kreut të pikës 6, ku të thuhet: “Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën e të gjithë anëtarëve.” Pastaj në ligj përcaktojmë se si zgjidhet me short e kështu me radhë.

Lidhur me paragrafin e shtatë të këtij ligji sugjeroj të ketë një riformulim si më poshtë: “Anëtarët prokurorë, të cilët vijnë në këshill nga prokuroria e posaçme për ndjekjen penale të veprave të korrupsionit, kriminit të organizuar dhe çështjeve kundër funksionarëve të lartë u pezullohet mandati gjatë kohës së shërbimit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Pra, kemi futur si element pezullimin e mandatit. Kjo bëhet vetëm për anëtarët e prokurorive të posaçme, si te rasti i Këshillit të Lartë. Pse e kemi bërë këtë diferencim midis

prokurorëve të zakonshëm dhe prokurorëve të prokurorive të posaçme? Sepse këta kanë një status të veçantë: nuk duhet të jenë të kërcënuar për vendin e punës, as të frikësuar dhe as nuk mund të humbasin pozicionin e tyre. Pastaj, pjesa tjetër e paragrafit, sikurse ka ardhur në projektin e paraqitur nga ekspertët e nivelit të lartë, ngelet ajo që është.

Fatmir Xhafaj – Po, kush ka diçka për këtë?

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Duke ndenjur në të njëjtat linja trajtimi për KLGJ-në, ne kemi një formulim të tillë të nenit: “Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, përgjegjshmërinë, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë si dhe siguron mbarëvajtjen e veprimtarisë së prokurorëve.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen prej Konferencës Kombëtare të Prokurorëve dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e juristëve joprokurorë.

Procedura e zgjedhjes së tyre garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin krahasimor të përmbushjes së kriterëve, transparencën dhe standardet e tjera të procesit të rregullt ligjor.

Anëtarët prokurorë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve, me integritet të lartë profesional dhe moral.

Konferenca Kombëtare e Prokurorëve i zgjedh anëtarët prokurorë me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë, duke siguruar përfaqësimin e drejtë të të gjitha shkallëve të prokurorisë.

Anëtarët joprokurorë duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe nuk duhet të kenë mbajtur poste politike apo poste në një parti politike gjatë, le të themi, 10 vjetëve të fundit”, por kjo ngelet për t’u diskutuar në rast se do të kemi dakordësi për ta ulur, pra “...përpara kandidimit. Ata duhet të kenë aftësi të spikatura profesionale dhe integritet profesional e moral, njohuri të thella ligjore dhe të paktën 15 vjet përvojë pune”. Këtu besoj do të kemi edhe debatin, por ne e kemi këtë formulë për mënyrën se si zgjidhen pesë anëtarët joprokurorë, pra që nuk vijnë nga radhët e prokurorëve.

“Anëtarët joprokurorë zgjidhen nga Kuvendi sipas metodës së kuotave të rezervuara, ku dy anëtarë përzgjidhen nga lista e mbështetur nga shumica parlamentare, 2 anëtarë zgjidhen nga lista e mbështetur nga pakica parlamentare dhe 1 anëtar zgjidhet me 3/5 e votave me propozim të shoqërisë civile”. Në këtë mënyrë ne mendojmë se garantojmë dhe shtojmë moskapjen politike të institucioneve.

“Rregulla më të detajuara për kushtet dhe kriteret, si dhe për procedurën e kandidimit dhe të zgjedhjes caktohen me ligj.

Për sa i përket kryetarit, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ai zgjidhet në mbledhjen e parë të këshillit nga radhët e anëtarëve joprokurorë me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se kryetari nuk zgjidhet në mbledhjen e parë, anëtari më i vjetër në moshë nga radhët e prokurorëve organizon zgjedhjen e kryetarit, me short, në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet e hapur. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit, anëtarët prokurorë rikthehen në vendet e mëparshme të punës.

Anëtarët joprokurorë, që përpara detyrës punonin me kohë të plotë në sektorin publik, në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Mandati i ushtruar rregullisht nga anëtari konsiderohet vlerë e shtuar e përvojës profesionale, sipas rregullave të përcaktuara me ligj”.

Ky është formulimi që ne mendojmë se shkon për këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – A ka tjetër?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me propozimin që bënë kolegët e opozitës për anëtarët joprokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, mendoj se propozimi e politizon shumë Këshillin e Lartë të Prokurorëve. Ne kemi po ato argumente kundër sikurse thamë edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Ne po bëjmë një reformë për të larguar ndikimin e politikës nga këto organe, që janë kaq shumë të rëndësishme për administrimin e prokurorisë dhe të gjykatave, pra kuotat, vendet e rezervuara, që propozon kolegu Ristani, e politizojnë më shumë nga sa është sot Këshillin e Lartë Gjyqësor apo Këshillin e Lartë të Prokurorëve.

Për të gjithë këtë nen, në pjesën tjetër ne jemi pak a shumë në të njëjtën linjë, nuk ka ndryshime.

Në prezantimin tim, unë nuk lexova ato pjesë të propozimit, të ardhur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, për të cilin ne nuk kishim ndryshime, por kam shtruar tri çështje për të cilat do të donim të binim dakord.

Lidhur me përbërjen e anëtarëve joprokurorë, biem dakord që do të jenë 5, por cilat do të jenë organet propozuese? Pra, unë ngrita një pyetje, që do të ishte mirë ta finalizonim: A do të ketë nga radhët e prokurorisë dhe nga shoqëria civile? Nëse jo, a biem dakord që këto dy vende t'i kalojnë një trupës së pedagogëve të drejtësisë dhe një t'i kalojë pedagogëve jogjyqtarë dhe prokurorë të Shkollës së Magjistraturës? Kjo lidhet me paragrafin 4 të këtij neni.

E dyta: A biem dakord që Kuvendi të rivotojë listën që ka ardhur veçmas për secilin grup kandidatësh? Nëse nuk arrin me 3/5, të zgjidhet njëri prej anëtarëve, të rivotohet po e njëjta listë? Argumenti që unë sjell është se zakonisht lista e parë është më cilësore sesa emrat që përfshihen në listat e dyta dhe të treta, bazuar edhe në përvojën që ne kemi sot, kur Presidenti paraqet dekrete dhe Kuvendi nuk i ka miratuar.

Çështja e tretë, për të cilën unë kërkoj një mendim nga ekspertët e profilizuar të prokurorisë së posaçme, është: A biem dakord të kemi një diferencim të anëtarëve prokurorë që vijnë në këshill nga prokuroria e posaçme në krahasim me anëtarët e tjerë, që vijnë nga prokuroria e zakonshme? Me fjalë të tjera që në nenin 7, ku thuhet: “Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme dhe në përfundim të mandatit anëtarët prokurorë rikthehen në vendet e mëparshme”, të shtojmë një fjali ku të thuhet: “..për anëtarët prokurorë, të cilët vijnë në këshill nga prokuroria e posaçme, mandati i tyre, që është 9-vjeçar, të pezullohet dhe pasi të mbarojnë këtë afat 5-vjeçar, ata të rikthehen në prokurori”, por nuk kemi marrë përgjigje, prandaj unë e shtrova si çështje.

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Kam një pyetje për trajtimin kushtetues dhe të formulës që ofron opozita për 2 përfaqësues të propozuar nga maxhoranca dhe dy përfaqësues të propozuar...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

(Të mbështetura, në rregull, “të mbështetura, të propozuara”, gjuha shqipe kjo është, por procedura parlamentare thotë “të propozuara”, sepse “mbështetja” nuk e di çfarë do të thotë: ta shtysh apo çfarë?)

..dhe dy nga opozita. Tani nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore, a mund ta di se çfarë kuptoni me maxhorancë, sepse maxhorancë do të thotë një shumicë matematike. Ligji do të kërkojë specifikime për partitë që kanë grupe parlamentare. Pyetja ime është: Çfarë do të thotë “në qoftë se ka më shumë se 3 grupe parlamentare në maxhorancë” apo “në qoftë se ka më shumë sesa dy grupe parlamentare në opozitë”. Si e mendoni ju, me vizionin tuaj ligjor

dhe kushtetues, formulën e propozimit nga politika për këto vende, për një institucion të pavarur?

Oerd Bylykbashi – Zoti Majko, besoj se kjo është një formulë e mirëstabilizuar dhe nuk kemi pasur probleme. KQZ-ja e ka këtë lloj koncepti dhe është rregulluar edhe pjesa e maxhorancës, edhe pjesa e opozitës, si dhe se si funksionon i gjithë mekanizmi.

Tani, nuk po themi se do të kopjohet ajo. E kemi thënë: kjo është çështje politike që kërkon zgjidhje. Ne kemi përzgjedhur këtë formulë, siç na e kanë propozuar edhe partnerët ndërkombëtarë, edhe Komisioni i Venecias e përmend si opsion. Tani, pa hyrë në detajet e kësaj, një gjë duhet të jetë e qartë: të jesh i propozuar nga politika, por profesionist dhe të jesh i politizuar, nuk janë e njëjta gjë. Është çështje stature, është çështje sjelljeje, është çështje për të cilën kontribuojmë edhe ne. Nga ana tjetër, jo më kot i kemi dhënë parlamentit të Shqipërisë, që në konceptin e *check and balance*, të propozojë këta pesë, pra të deleguarit e popullit të kontrollojnë atë që bën gjyqësori, përndryshe i bënim të gjithë prokurorë. Këta nuk janë për të siguruar përgjegjshmërinë e prokurorëve të noterët, tek avokatët, të profesorët e fakultetit X apo Y, jo. Këta janë për të garantuar përgjegjshmërinë të publiku dhe me Kushtetutë kjo i është dhënë parlamentit. Kjo nuk do të thotë se i politizon gjërat, sepse për këtë arsye në Kushtetutë po vendosim kritere të forta se kush do të jenë këta persona. Nuk po çojmë politikanin e radhës, por po çojmë persona, që vijnë nga këto lloj grupesh. Kështu që të mos i ngatërrojnë konceptet. Besoj se do ta gjejmë një zgjidhje bashkë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në qoftë se opozita ka ardhur me paralelen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu siç, të paktën, m'u dëgjua mua nga fjalët që tha parafolësi, mendoj se ka gjetur pikën më të dobët për ta marrë si paralele.

Së pari, KQZ-ja menaxhon një proces tërësisht politik, kurse prokuroria, të nderuar kolegë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Pandeli Majko – Në qoftë se sollët si paralele për këtë formulë, që na ofroni për sistemin e prokurorisë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dëshiroj të them se KQZ-ja menaxhon një proces, i cili është fund e krye politik dhe ka të bëjë me interesat e politikës dhe sigurisht balancimi politik është i rëndësishëm, sigurisht edhe profesional, por, mbi të gjitha, provokacioni politik që ka.

Sistemi i prokurorisë, institucioni i prokurorisë është një histori krejtësisht tjetër nga KQZ-ja. Ai nuk menaxhon asnjë proces politik, nuk menaxhon asnjë interes politik, madje do

të më falni, politika, në marrëdhënie me emërimet në institucionin e prokurorisë mund të ketë “një konflikt interesi”, pasi do të jetë institucioni, i cili, në një mënyrë apo në një tjetër, do të hetojë edhe veprimtarinë e politikës. Kështu që kam përshtypjen se ashtu siç është ofruar drafti edhe nga ekspertët dhe nga ajo që kam lexuar unë nga vërejtjet e Komisionit të Venecias, por edhe nga diskutimet që kemi pasur në tavolinat e përgjithshme, parimi që ne kemi ndjekur është: juristët të vendosin për juristët.

Unë nuk mendoj se propozimin që është këtu, që të zgjidhen nga radhët e avokatëve apo nga radhët e noterëve, apo nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, apo nga trupa e pedagogëve jogjyqtarë, ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, një përfaqësues nga shoqëria civile e kështu me radhë, ta fiksojmë që të gjitha këto propozime do të kalojnë te Këshilli i Emërimeve të Drejtësisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe të gjithë këtij sistemi do të rilevojë, do të përcaktojë qartë plotësimin e kushteve që duhet të plotësojnë këta njerëz, të gjitha nga pikëpamja juridike. Ajo që na propozoni ju është ta kthejmë sistemin kokëposhtë dhe të rikthehemi edhe një herë te psikologjia e KLD-së të njëjtën formulë na e thatë edhe për KLGJ-në. Tani, unë po e them qartë, se në qoftë se doni që procesin e emërimeve në prokurori dhe procesin e emërimit të gjyqtarëve, t’i keni si përfaqësim të politikës apo si garanci të politikës, dhe me këtë nuk dua që të jem ironik, atëherë ne e bëjmë kot këtë reformë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë e kemi shumë mirë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko! Fjalën e ka kërkuar zoti Mediu.

Fatmir Mediu Ne po flasim për zgjedhjet që bën parlamenti dhe nuk janë juristët që zgjedhin juristët, por është parlamenti që zgjedh juristët dhe parlamenti është i përbërë nga politikanë që janë juristë, s’janë juristë, traktoristë, ballistë e të gjitha. Pra, janë një trupë politike të cilët zgjedhin në bazë të propozimeve që vijnë. Unë nuk mendoj se ruhet pavarësia nga politika që juristët i zgjedh vetëm maxhoranca, dhe ky është preokupimi ynë, që maxhoranca të mos ketë dorë, por të kemi një mirëkuptim politik për të gjetur trupën më të mirë dhe pavarësinë maksimale të prokurorisë. Duke pasur këtë shqetësim të hershëm, ne kemi diskutuar dhe negociuar edhe me faktorin ndërkombëtar, dhe ky propozim që juve ju duket kaq negativ, nuk është një propozim thjesht i bërë nga ne, por në një marrëveshje me faktorin ndërkombëtar, të cilën ju donit ta miratonit pa e parë fare, kurse tani po e gjykoni. Ajo çka po themi ne, edhe njëherë, është që të gjejmë një zgjidhje, me qëllim që të mos e ketë as maxhoranca dhe as opozita të drejtën absolute për të ndikuar politikisht në institucionin e prokurorisë. Në qoftë se ju duket se zgjidhja është që juristët po zgjedhin juristët, Këshilli i Emërimeve, Këshilli i Lartë i Emërimeve në Prokurori, atëherë për çfarë duhet parlamenti,

sepse nuk vlen parlamenti të diskutojë për asgjë, sepse ti sapo e the që juristët zgjedhin juristët. Juristët zgjedhin juristët dhe parlamenti nuk duhet që të jetë gjëkund, atëherë.

Fatmir Xhafaj - Qartë.

Fatmir Mediu – Ne po të themi, që për pjesën që zgjedh parlamenti, të gjejmë një rregull dhe një marrëdhënie funksionale, të cilën na e sugjeroi edhe faktori ndërkombëtar në muajin shkurt dhe ne e kemi pranuar. Po ta them pak më tej, sepse unë përmenda një rast, dhe ju zoti Majko, nuk ngritët shqetësimin se çfarë propozon pozita dhe opozita, por thatë si do t'ia bëjmë problemit që kemi brenda pozitës dhe opozitës, se cili grup do ta bëjë dhe se si. Ju ngritët se kush do ta propozojë dhe unë, thjesht duke gjykuar apriori, ju thashë rastin e KQZ-së, nuk është për ta marrë si rasti që ka të bëjë me prokurorinë për t'iu referuar ju, aspak, as ne, por ne po i referohemi një formule që është ofruar këtu për të gjetur një zgjidhje të përbashkët. Ne kemi rënë dakord me faktorin ndërkombëtar që ka negociuar për këtë çështje dhe tani ju ngelet juve për të thënë që jeni apo nuk jeni dakord. Në qoftë se ju përfaqësoni zërin e të gjithëve, si edhe vullnetin e atyre që nuk janë këtu, në autoritetin e negocimit në politikë, përveçse teknik në komision, thoni që të dimë edhe ne se si të veprojmë më tej.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri - Zoti Majko, KQZ-ja është një organ kushtetues, që menaxhon një proces ligjor bazuar mbi një kod të Republikës, subjekt i të cilit janë partitë politike dhe qytetarët, dhe nuk është një organ politik që menaxhon një proces politik. Prokuroria dhe gjykatat janë po ashtu organe kushtetuese, të zgjedhura për të drejtuar apo menaxhuar një proces po ashtu ligjor, mbështetur në disa kode të tjera të Republikës po aq të rëndësishme, subjekt i të cilave janë individët, politikanë ose jo, çdo qytetar i këtij vendi përfshirë edhe partitë politike. Kështu që, nga kjo pikëpamje nuk është se ka ndonjë dallim. Ne në këtë sallë kemi qenë kur diskutohej për anëtarët e KQZ-së, dorëheqjet, jo dorëheqjet, dhe ju thoshit që janë profesionistë dhe nuk janë në politikë. Bëhet fjalë për pjesën tuaj në vitin 2013. Tani, ose ata i keni zgjedhur politikisht për besnikëri politike në KQZ dhe janë në politikë, dhe si ai model nuk duhet, sepse në vitin 2013 thoshit ndryshe, që nuk kanë lidhje me ne dhe se ata kanë integritetin e tyre, ose është kjo që po thoni sot, që ata janë njerëz politikë të zgjedhur për besnikëri politike, për të menaxhuar në bazë të ligjit një proces. Prandaj është e balancuar politikisht që të jenë të baraslarguar nga palët politike. Formula me të cilën ne kemi ecur deri sot, dhe kam përshtypjen se eksperiencia duhet të na e tregojë dhe do t'u kthehemi pak statistikave. Ne, të gjithë bashkë, herë ne në opozitë dhe herë ju në opozitë, kemi zgjedhur anëtarë të Gjykatës së Lartë, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe mua nuk më duket se vendimet që janë marrë ju kanë mbajtur me hatër ju apo na kanë mbajtur me hatër ne,

përkundrazi, statistikë është. Pjesa më e madhe, e atyre që ne u kemi dhënë besimin, për aq sa patëm në dorë 6 apo 7-vjet, në vëzhgimin tim kanë dhënë vendimet më skandaloze kundër nesh dhe kjo nuk ka lidhje me besnikërinë politike. Besimin për integritet dhe profesionalizëm e kanë marrë nga ne në maxhorancë dhe e njëjta gjë ju ka ndodhur edhe ju. Jemi dakord këtu, apo jo? Gjyqësori nuk është ndarë kurrë në bazë të besnikërisë politike, përkundrazi edhe ju keni raste edhe ne kemi raste dhe nuk është faji i formulës. Pastaj, nëse është më e aftë trupa gjyqësore, është më i aftë parlamenti apo hajde të gjejmë artifice të tjera, sepse gjatë mekanizmi i zgjedhjes është ai që u jep ose u heq integritet profesional, mua kjo nuk më duket... Mekanizmi i zgjedhjes është një mekanizëm zgjedhje që i mban larg duart e tua dhe të miat nga ajo punë. Nuk u jep më shumë integritet nga ç'kanë dhe ne po flasim për formulën, nuk po flasim se si t'u japim më shumë integritet. Nëse nisemi mbi një bazë për të vendosur disa kriteret dhe standarde se si do të operojmë më pas, të gjitha këto që thashë duhet që t'i kemi parasysh, sepse janë fjalë që ti dhe unë i kemi thënë në këtë sallë në periudha të ndryshme për të njëjtat institucione. Prandaj, të mos humbasim kohë kot, por të shikojmë se çfarë mund të bëjmë dhe çfarë mund të rregullojmë sot, dhe jo çfarë mund të prishim dhe as se si mund të fshihemi pas gishtit. Unë besoj se formula që ne japim ka bazë mbi të cilën ne mund të diskutojmë dhe sigurisht që mund të mos jetë perfekte, por jo për ato arsye që thotë zoti Majko.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Nuk është momenti për ta diskutuar këtë gjë. Ju lutem, fokusohuni tek ajo që është çështje për debat këtu. Dha një paraqitje,...

(Diskutim pa mikrofon.)

Dakord. Ju keni të drejtën tuaj, por jeni duke e shtruar për çështjen e gabuar dhe në momentin e gabuar. Kjo është ajo që dua t'ju them. Pastaj, s'e di duhet të jetë dhe si do jetë, ka kohë përpara.

(Diskutim pa mikrofon.)

Dakord, por po diskuton për një gjë që nuk është vendi sot dhe na hëngre kohën. Në vend që të merreshim me nenin, u morëm se si e mendoni ju KQZ-në.

(Diskutim pa mikrofon.)

Po nuk jua ndërpreva fjalën dhe mirë bëra.

(Diskutim pa mikrofon.)

Nuk është kështu, por megjithatë jam dakord, po e bëjmë gjashtë me pesë...

(Diskutim pa mikrofon.)

Jo, janë ex officio për shkak të detyrës. Tre kishim nga...

(Diskutim pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, a mund t’ia kurseni këtij Komisioni dhe vetes këtë debat të panevojshëm.

(Diskutim pa mikrofon.)

Atëherë, e mbyllëm edhe 46 - n dhe tani do të vazhdojmë me 47- n, por për shkak të një kërkesë për një aktivitet partiak të kolegëve të Partisë Demokratike, do ta vazhdojmë në orën 15:00 pasdite.

ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi për shqyrtimin nen për nen të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, për grupin e IV-t të dispozitave, pjesa e prokurorisë,(nenet 47 - 56).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Arben Ristani, Oerd Bylykbashi, Jorida Tabaku, Gent Strazimiri dhe Fatmir Mediu.

Mungon:

Eduard Halimi, Spartak Braho.

Të ftuar:

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mbaruam me nenin 46.

Vazhdojmë me nenin 47.

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në nenin 47 bëhet fjalë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Unë kam dy propozime për ndryshime gjuhësore dhe ndonjë shkurtim.

Germat “a” dhe “b” po i lexoj, sepse aty është më shumë ndërhyrja. Te pika 1 është: “Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi: a. Emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha shkallëve”. Këtu mbaron paragrafi. Të tjera janë:

“duke përfshirë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të nenit 179/b”. Mendoj se është një gjë që mund të shmanget, megjithatë mund ta shikojnë ekspertët.

Te germa “b” propozoj: “Vendos për masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha shkallëve”.

Germa “c” “ç” mbeten siç janë. Germa “d”: “Propozon dhe administron buxhetin e tij”, se është bërë “e saj”, vetëm kjo duhet të ndryshohet. Pika 2 mbetet ashtu siç është.

Pika 3 propozoj që të rishkruhet: “Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve me fuqi vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo. Pika 3 riformulohet. Thuhet: “Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të krijojë dhe të vendosë nënkomisione”, propozimi im është: “Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve me fuqi vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Tani, propozoj të shtohet një pikë, 4 që është në analogji edhe me propozimet që kemi bërë për KLGJ. Pra, propozoj të shtohet një pikë 4: “Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur diskutohen çështje që kanë lidhje me politikën e përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë penale dhe të organizimit e të funksionimit të prokurorisë, si edhe planifikimin strategjik dhe buxhetin e prokurorisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk besoj se ne duhet t’ia vëmë detyrë ministrit, por kam përshtypjen që lë të hapur një bashkëpunim për këto çështje. Edhe, për KLGJ- në i njëjti formulim është.

Fatmir Mediu – Me ftesë të këtij të fundit.

Fatmir Xhafaj – E rregullojmë.

Fatmir Mediu - Më falni vetëm për një arsye, sepse shpesh.

Fatmir Xhafaj – Ashtu siç tha edhe Oerdi, mund ta shkruajmë: “Merr pjesë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këshilli është i detyruar t’i dërgojë njoftim, atëherë kur ka njoftim.

A kemi ndonjë mendim tjetër për nenin 47, meqenëse ruan të njëjtën natyrë me sugjerimet që u bënë për KLGJ-në?

Pra, të kuptohemi, të jetë e qartë edhe për ekspertët dhe dëshiroj që të jetë e qartë për përkthyesin, sepse paradite kam konstatuar disa gjëra që kanë shpëputje ndërmjet asaj që flitet këtu dhe asaj që përkthehet, ndoshta nga shpejtësia, kështu që do t’ju lutesha, kur ta keni të nevojshme, na thoni: po ecni shpejt. Ne do të reagojmë. Pra, zoti Majko nuk preku thelbin

e dispozitës. Propozimi ishte për disa redaktime gjuhësore dhe disa redaktime frazash, duke ruajtur thelbin e dispozitës.

Pandeli Majko – Pra, të pandryshuar. Nëse ekspertët kanë ndonjë...

Fatmir Xhafaj – Dhe është analogji me ndërhyrjet që bëjnë te Këshilli i Lartë i Gjyqësorit.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, duke marrë të mirëqenë që rifliten problemet e KLGJ-së, dhe për sa i përket faktit, sa është e nevojshme reflektohen këtu me ndryshimet e nevojshme ato komente, pra për shkak të natyrës dhe formulimeve specifike që ka ky nen, edhe ne bëjmë një propozim konkret në lidhje me këtë për sa u përket funksioneve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. “Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron funksionet e mëposhtme:

a. Përzgjedh emëron, vlerëson, merr në detyrë, transferon dhe deklaron mbarimin e detyrës së prokurorit në të gjitha nivelet.

b. Shqyrton ankesat ndaj prokurorëve të prokurorisë së posaçme si dhe vendos për masat e disiplinore ndaj të gjithë prokurorëve, me përjashtim të prokurorit të Përgjithshëm.

c. Shqyrton rastet dhe paraqet para organit kompetent kërkesën për të verifikuar zgjedhshmërinë edhe pajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit, si edhe për deklarimin e mbarimit të detyrës së prokurorit.

ç. I propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

d. Shqyrton dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis prokurorëve për paligjshmërinë e udhëzimeve të dhëna nga prokurorët më të lartë, me përjashtim të udhëzimeve të përgjithshme të prokurorit të Përgjithshëm.

dh. Miraton rregullat e etikës së prokurorit dhe mbikëqyr respektimin e tyre.

e. Propozon dhe administron buxhetin e tij.

ë. Mbikëqyr trajnimin profesional të prokurorit të të gjitha niveleve.

f. Mbron figurën e prokurorit dhe të prokurorisë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë informon të paktën një herë në vit publikun dhe Kuvendin për ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli ushtron dhe funksione të tjera të përcaktuara me ligj”.

Vazhdojmë me një propozim për një nen tjetër.

1. “Këshilli i Lartë i Prokurorëve, për ushtrimin e funksionit të tij organizohet dhe vendos nënkomisione të përhershme, të përbëra nga anëtarët e tij, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.

2. Komisioni disiplinor është një prej komisioneve të përhershme që verifikon ankesat ndaj prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, heton me nismën e tij shkeljet disiplinore të këtyre prokurorëve dhe vendos nëse është rasti fillimit të procedimit disiplinor ndaj tyre. Ai përbëhet nga dy anëtarë joprokurorë dhe një prokuror. Anëtarët e Komisionit Disiplinor zgjidhen me short çdo dy vjet. Komisioni kryesohet nga anëtari prokuror.

Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit të Lartë të Prokurorëve vetëm kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik.

4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe komisionet e tij, në ushtrimin e funksioneve, ndihmohen nga administrata, e cila përgjigjet para Këshillit”.

Fatmir Xhafaj – Nuk ju duket se disa gjëra që kërkon të shtohen janë për ligjin? Janë gjëra që janë në ligj, nuk janë për në Kushtetutë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, në gjykimin tonë, ky është një propozim që ne do ta diskutojmë. Pastaj besoj do ta gjejmë zgjidhjen.

Fatmir Xhafaj – Por nuk kemi shumë kohë për të diskutuar.

Oerd Bylykbashi– Unë besoj se do ta gjejmë zgjidhjen për të thënë se çfarë është e tepërt këtu dhe çfarë...

Fatmir Xhafaj – Dakord, ne do t’i hedhim në votë të dy dhe pastaj do të vazhdojmë.

Oerd Bylykbashi– Do të vijë momenti kur..

Fatmir Xhafaj – Ka kaluar momenti.

Oerd Bylykbashi - Nuk ka kaluar asnjë lloj momenti, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Do ta shohim hap pas hapi.

A keni ndonjë gjë tjetër për nenin 47?

Fatmir Mediu – Do ta çmojmë pa dyshim edhe shqetësimin që ju thoni se mund të jetë në ligj dhe jo për në Kushtetutë, për ta çmojmë në mënyrë të përmbajtur që ta hedhim në votë apo të mos e hedhim në votë. Ju mund të shtoni këtë që paraqiti si shtesë zoti Majko.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk shtojmë.

Fatmir Mediu – Për shembull: “Ministri duhet të marrë pjesë”.

Fatmir Xhafaj - Është standardi.

Fatmir Mediu - Dakord është standard, ne kemi menduar se duhet të përfshihet edhe nga kjo pikëpamje, pa dyshim që kërkon një gjykim më konstitucionalist qoftë edhe me ndihmën e ekspertëve, që do të jenë apo jo në ligj.

Fatmir Xhafaj – Bie dakord me këtë logjikë që ju thoni se do t'ua lëmë në dorë ekspertëve .

Fatmir Mediu- Edhe njëri – tjetrit, kur të marrim në konsideratë fjalën tuaj ku thoni se kjo pjesë duhet në ligj.

Fatmir Xhafaj – Është gjuhë ligji ajo, zoti Mediu. A bie dakord me mua tani që ta shkruash në Kushtetutë që “Këshilli i Lartë i Prokurorisë ndihmohet nga administrata e tij”?

Fatmir Mediu- Unë nuk po hyj në meritën e asaj çfarë është shkruar, por hyj tek shqetësimi që thatë ju.

Fatmir Xhafaj - Është gjuhë ligji. Dakord unë po e ngre si shqetësim.

Fatmir Mediu - Si praktikë procedurale po themi është më mirë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Për procedurë dhe për të mbetur në transkript, e përsëris, të gjitha propozimet që unë kam bërë do të kalojnë nga filtri i dy ekspertëve ndërkombëtarë, siç kemi rënë në fillim dakord. Nëse ata do të japin dakordësinë, unë do t'i mirëkuptoj. Nuk e ndiej veten të ndërvarur thjesht dhe vetëm nga ekspertiza ndërkombëtare, por i kam besuar ata që në fillim dhe kjo do të jetë vija e sjelljes sonë në vazhdim.

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër. Për nenin 47?

Gent Strazimiri – Në përgjithësi, për metodologjinë që po ndjekim, këto pyetje dhe sugjerimet që ju bëtë, i keni thjesht personale secili apo është një reflektim më i gjerë nga pikëpamja e forcës politike?

Fatmir Xhafaj – Jo, sepse ne kemi një reflektim të përbashkët edhe të forcës politike edhe të ekspertëve. Ju e keni thjesht personale apo? Këtu kemi ardhur si ligjvënës.

Kjo është zgjedhje që mund të bëni ju, ta bëni historinë me Partinë Demokratike, por këtu nuk është historia e Partisë Demokratike, këtu është historia e shtetit shqiptar. Ne jemi ligjvënës. Zoti Majko është një ligjvënës, sikundër edhe ju zoti Strazimiri jeni një ligjvënës, si të gjithë ne të tjerët, dhe duhet të sillemi si ligjvënës.

Gent Strazimiri - Unë bëra një pyetje që ka lidhje vetëm me metodologjinë. Kërkova sinqeritet...

Fatmir Xhafaj – Nuk është metodologji frymëzimi partiak.

Gent Strazimiri - Kaq sinqeritet patët të më jepnit. Është pozitë dhe opozitë, përfaqësojmë disa parti. Unë bëra një pyetje për metodologjinë. Këtu keni mendimin e opozitës, të kristalizuar. Ti ke mendimin e individëve apo të maxhorancës? Këtë po pyes.

Fatmir Xhafaj – Jemi anëtarë të komisionit.

Gent Strazimiri - Individësh.

Fatmir Xhafaj - Jemi anëtarë të komisionit.

Gent Strazimiri - E kuptova.

Fatmir Xhafaj - Kemi mandat si ligjvënës. Është shumë e rëndësishme që ne të sillemi si ligjvënës.

Neni 45. “Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Keni ndonjë gjë? Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Për sa i përket kësaj, referoj njëlloj si më parë, mbeten komentet që janë bërë më parë te neni 37 për sa u përket problemeve për t’u zgjidhur, por kam një propozim konkret. Në mos gaboj, në mbledhjen e kaluar ju bëtë një propozim që ndoshta do të vijë një moment të sintetizojmë dispozita të ngjashme, edhe te prokuroria, edhe te gjyqësori në një dorë të vetme.

Fatmir Xhafaj – Jo në një dorë, t’i përmbledhim në një dispozitë të gjitha ato që lidhen me mandatin për shkak të ngjashmërisë, përafërsisë që kanë për të mos pasur dispozita të shpërndara për të njëjtën çështje, mund t’i përmbledhim në një dispozitë të vetme, nëse ekspertët do ta çmojnë të arsyeshme nga pikëpamja e teknikës legjislative. Ky ishte një propozim.

Oerd Bylykbashi – Duke e çmuar me vend këtë...

Fatmir Xhafaj - U mbetet atyre ta ndajnë.

Oerd Bylykbashi – I bie të lexoj një propozim, i cili do të shkonte në këtë linjë, por do të përsëritet edhe në lidhje me trupat e të tjera, edhe me gjyqësorin që e kemi tashmë. Po limitohem në një përshkrim të shkurtër të disa neneve që do të aplikohen në të dyja pjesët. Ne mund të rregullojmë me një dispozitë imunitetin për mendimet dhe vendimet e marra nga gjyqtarët, por edhe nga prokurorët. Mund të rregullojmë çështjen e papajtueshmërisë së gjyqtarëve, por edhe të zyrtarëve të tjerë, përfshirë Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm apo Këshillin e Lartë të Prokurorisë për papajtueshmërinë e funksioneve. Në rastin konkret mund të lexoj një propozim që do të shkonte për të dy:

“Gjyqtari apo prokurori nuk mund të largohet nga detyra përveç rasteve kur:

“a”. Mbush moshën e pensionit 70 vjeç”.

Ne gjykojmë se duhet të hiqet çështja e përfundimit të mandatit, sepse është e përcaktuar. Vazhdon propozimi:

“b”. Kur është me detyrë, me mandat jep dorëheqjen.

“c”. Jepet masa e shkarkimit nga detyra.

“ç”. Vërtetohet se është në kushtet e pavlefshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit apo të prokurorit.

“d”. Vërtetohet se është në pamundësi fizike apo mendore për të ushtruar detyrën”.

Këtu më pas vazhdojmë me një paragraf tjetër.

“Rregulli i paragrafit 1 zbatohet edhe për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë edhe për Prokurorin e Përgjithshëm”.

“Mbarimi i mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si dhe mbarimi i detyrës së gjyqtarëve të tjerë deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mbarimi i mandatit të prokurorit të Përgjithshëm dhe mbarimi i detyrës së prokurorëve të tjerë deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Ky është një model, për të cilin ne mund të biem dakord, siç e thatë edhe ju, për një draftim që i përmbledh të gjitha, ndërkohë e diskutojmë edhe me ekspertët ndërkombëtarë, për të gjetur funksionalitetin maksimal në dispozitë.

Më pas edhe çështjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë...

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka procedurat për zëvendësimin në kohë të mjaftueshme para përfundimit të mandatit apo në rastet e mbarimit të parakohshëm, edhe ato të rregulluara në një dispozitë që i përmbledh.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Mbarojmë me nenin 48, meqenëse është i njëjtë me nenin për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Neni 49. Jeni dakord?

Oerd Bylykbashi – Mbeten po ato komente, siç kemi bërë për nenin 38, përfshirë ato që thashë më përpara lidhur me faktorizimin në një dispozitë të të gjitha parashikimeve.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 49. Neni 50.

Oerd Bylykbashi - Kemi po të njëjtat komente, në referim të nenit 39.

Fatmir Xhafaj – Kemi diskutuar për ndryshimin që kemi bërë, është gjë teknike. Jemi dakord edhe me nenin 50, me sugjerimin teknik të bërë.

Neni 51. “Neni 149 ndryshohet si më poshtë vijon”.

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Në lidhje me nenin 51 që ndryshon nenin 149 të Kushtetutës që për efekt të shqipërimin më të mirë dhe të një sintetizimi të një gjuhe juridike dhe kushtetuese, pa e prekur përmbajtjen dhe thelbin e këtij neni, propozoj një riformulim të nenit 51 në katër paragrafë.

Neni 51, pika 1.

“Prokurori i Përgjithshëm emërohet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi”.

Pika 2. “Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente sipas ligjit”.

Pika 3. “Nëse Kuvendi nuk emëron Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i ri i renditur më lart nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konsiderohet i emëruar”.

Pika 4. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Kandidati për Prokuror të Përgjithshëm nuk duhet të ketë qenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Në riformulimin e nenit 51, në pikën 4 unë sugjeroj të hiqen fjalët “pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës ose me gradë shkencore në drejtësi”. Pra, fjalët “ose me gradë shkencore në drejtësi dhe kriteret për prokurorin e Përgjithshëm” të hiqen. Pra, duhet të jetë ose njëra ose tjetra, sepse është proporcionale që të ketë dy kritere njëkohësisht. Pra, Shkollën e Magjistraturës ose gradë shkencore në drejtësi. Gjithsesi, ky është propozimi im për riformulimin e këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Pra, nga ajo që kuptoj unë është se ju e ruani nenin siç është, por thjesht bëni një riformatim.

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu -Domethënë, ne duhet t’i qëndrojmë logjikës që duhet të ketë 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional dhe të jetë prokuror vetëm pasi ta ketë përfunduar Magjistraturën ose ka gradë shkencore. Do të jetë përjashtuese po nuk e pati?

Fatmir Xhafaj – Në mënyrën se si është formuluar nënkupton se nuk mund të bëhet Prokuror i Përgjithshëm dikush që nuk ka Shkollën e Magjistraturës. Këtë e kanë shkruar ekspertët të zezën mbi të bardhë. Gjithsesi, a mund t’i pyesim ekspertët?

Fatmir Mediu – Fakti është që Shkolla e Magjistraturës ka një kohë që funksionon në Shqipëri. Por si i gjithë sistemi i drejtësisë duhet të shikojmë dhe handikapin e Shkollës së Magjistraturës. Do të ecim tek integriteti që kemi thënë, si dhe përvoja e punës. Bëhet fjalë për integritet profesional dhe moral apo do ta ngushtojmë rrethin te Shkolla e Magjistraturës? Në qoftë se e ngushtojmë këtë rreth, do të kemi më pak mundësi për të përzgjedhur elementet e para të integritetit moral dhe profesional. Jo të gjithë ata që kanë mbaruar Magjistraturën janë yje të shkëlqyer. Një pjesë e tyre kanë probleme jo të vogla, të paktën nga historiku i gjyqësorit apo i prokurorisë. A duhet ta kemi këtë rast përjashtimor?

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, për këtë pikën...

Fatmir Xhafaj – Unë ju thashë të mos bëni komente, por pyetje. Apo do të dëgjoni përgjigjen e ekspertëve.

Vasilika Hysi – Jo, pyetje nuk kam.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, ka drejtuar një pyetje. Të marrim një herë përgjigjen. Faleminderit!

A keni ju një përgjigje?

Jon Smibert – Neni 149, në lidhje me shkollimin e Prokurorit të Përgjithshëm, kemi qenë gjithmonë të shqetësuar në lidhje me faktin se për këtë periudhë kohore, Shkolla e Magjistraturës ka një histori prej vetëm 13 vjetësh ekzistence dhe vetëm një numër shumë i vogël personash mund të kualifikohet nëse vendoset kushti i Shkollës së Magjistraturës. Ne gjithashtu besojmë se detyra, fokusi i Prokurorit të Përgjithshëm ka ndryshuar. Një nga rolet e tij është të përfaqësojë në Gjykatën e Lartë çështjet penale dhe ai ose ajo do duhet të ketë një shkollim të lartë në drejtësi ose nga Shkolla e Magjistraturës, në mënyrë që argumentet e tij/saj të vlerësohen para Gjykatës së Lartë. Duhet Shkolla e Magjistraturës dhe diploma akademike në drejtësi, duke pasur idenë për t'i përfaqësuar të dyja për tre arsye. E para, për të mos e ngushtuar rrethin e personave, veçanërisht tani në fillim. E dyta, duhet të jetë dikush i cili mund të argumentojë mirë në emër të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe e treta është se funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm është në luftën kundër kriminalitetit dhe shpresojmë se duke pasur këtë diplomë shtesë në drejtësi apo eksperiencën, do të kemi një person i cili e ka marrë shumë seriozisht karrierën e tij dhe një person i cili është i aftë të artikulojë arsyet se përse duhet të fokusohemi në gjëra të caktuara si anti-korrupsioni, narkotikët etj. Kjo është arsyeja se përse e kemi formuluar në këtë mënyrë. Nëse hiqni diplomën në drejtësi, do duhet të shikonim se sa vite eksperiencë janë të mjaftueshme për t'u bërë Prokuror i Përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Mediu ka një pyetje tjetër.

Fatmir Mediu – Shqetësimi im, që ta sqaroj edhe një herë situatën, është që një grup prokurorësh të ndershëm apo edhe juristësh të ndershëm që janë në gjyqësor për shkak edhe të pozicionit të punës që kanë pasur nuk e kanë pasur detyrim kryerjen e Shkollës së Magjistraturës. Kjo nuk do të thotë se ata janë me integritet moral apo formim profesional më të cekët sesa ata që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Si zgjidhet probabiliteti që edhe nga këta njerëz ne të kemi mundësi të shikojmë për të gjetur prokurorin e përgjithshëm?

Së dyti, sistemi i edukimit në Shqipëri, përfshirë edhe Shkollën e Magjistraturës, nuk ka qenë një sistem perfekt, ka edhe ai çalesat e veta. Nëse ne do ta ngushtojmë përzgjedhjen vetëm tek ata që kanë mbaruar Magjistraturën, më tepër do t'i rrimë vlerës skolare të formimit edukativ dhe shumë më pak integritetit dhe përvojës profesionale, që mbetet në gjykimin e atyre që marrin vendimin. Pra, gjithë shqetësimin nuk e kam nëse ka mbaruar apo jo Shkollën e Magjistraturës, por ne nuk kemi kaq kualitete, e kemi provuar këtë.

Përrjashtojmë ata që janë nga politika, përrjashtojmë ata që nuk kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, përrjashtojmë ata që për një apo një arsye tjetër nuk kualifikohen sipas këtyre kriterëve, rrethi ku ne tentojmë të zgjedhim duket sikur përcakton korniza të sakta, po ngushton përmasën e njerëzve që vërtet mund ta kryejnë me integritet dhe në funksionalitet të plotë detyrën. Ky është shqetësimi im.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Rainer keni një koment?

Rainer Deville – Në këtë rast është Shkolla e Magjistraturës ose diplomë akademike në drejtësi. Në kohët e sotme, patjetër që iu nevojiten të dyja kriteret, pasi nuk ka njerëz të mjaftueshëm që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës. Duke pasur vetëm 13 vjet eksperiencë, mbase nuk ka asnjë.

Në aspektin afatgjatë, për kohëzgjatjen e Kushtetutës, do duhet të shikoni se në paragrafin 1, kandidatët më të kualifikuar dhe me reputacion duhet të zgjidhen dhe në plan afatgjatë, personat të cilët vijnë nga Shkolla e Magjistraturës mund të kenë një kualifikim shtesë në krahasim me dikë që ka vetëm një diplomë në drejtësi. Prandaj bën sens që të dy kriteret të qëndrojnë pasi kjo është shkruar për sot dhe për një periudhë 20-vjeçare.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Jon Smibert- Mendoj se është më shumë një çështje gjuhësore pasi qëllimi fillestar ka qenë për një zgjedhje midis Shkollës së Magjistraturës dhe një diplomë ekuivalente si p.sh ajo e studimeve Master në drejtësi. Ka pasur debate në botën akademike dhe ne kemi parë një sërë opsionesh.

Fatmir Xhafaj – Besoj se kemi mirëkuptim se si e shohin ekspertët. Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Edhe unë e shikoj si ekspertët, por në rast se unë jam për të pasur Shkollën e Magjistraturës ose një që ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë, ka një gradë shkencore, që ka integritet të lartë moral dhe profesional, në rast se do ta lëmë kështu siç është në draft, nuk duhet të fshijmë pikërisht fjalinë e fundit të paragrafit të tretë të projektit ku duhet thënë që ky kandidat, i cili nuk vjen nga Shkolla e Magjistraturës, pra që ka gradën shkencore, jo vetëm që duhet të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, por ai nuk

duhet të ketë mbajtur edhe funksione politike në administratën publike dhe pozicionet drejtuese në partitë politike.

Pse e them këtë? Kjo te Shkolla e Magjistraturës nuk është kërkesë, sepse në Shkollën e Magjistraturës nuk pranohesh, sepse vetë kjo shkollë ka disa kriterë selektive. Hapja që bëhet për të pasur edhe persona që nuk kanë mbaruar studimet në Shkollën e Magjistraturës, por kanë mbaruar studimet në Fakultetin e Drejtësisë e riskon më shumë që ai të ketë pasur aktivitet politik. Duke pasur parasysh që Shkolla e Magjistraturës ka nxjerrë brezin e parë në vitin 1999 dhe mesatarisht çdo vit në vitet e fundit ka pasur nga 8, 10, 12 prokurorë, për të qenë të sigurt do të kemi mjaftueshëm kandidatë që të ketë një përzgjedhje shumë të mirë jo vetëm për prokurorë të përgjithshëm, por edhe për prokurorë në apel.

Për të kaluar procesin e vlerësimit do të doja që të ishte ose njëra ose tjetra me kriterë të përforcuara për ata që nuk vijnë nga Shkolla e Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Do t'ju lutem që të mbani në konsideratë edhe një herë. Po flasim për nene kushtetuese. Ligji ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të përcaktuar kriterë orientuese. Mjafton që ligji të mos ketë një gjë të përcaktuar shprehimisht në normën kushtetuese. Ligji nuk mund të dalë mbi parashikimin kushtetues, por nëse nuk është parashikuar në Kushtetutë, ligji ka hapësirën e nevojshme për ta krijuar të gjithë lirinë dhe mundësinë e përzgjedhjes.

Oerd Bylykbashi – Dakord jam, kryetar, por jo liri përtej kufizimeve bazë kushtetuese, se një nga shqetësimet tona kjo është. Dhe dakordësia kjo ka qenë.

Fatmir Xhafaj – Ne të dy jemi juristë dhe shumica jonë këtu jemi ligjvënës që kemi një përvojë konkrete. Dhe e dimë që nëse Kushtetuta vendos një kufizim, ligji nuk mund të kalojë përtej atij kufizimi. Nëse Kushtetuta nuk e parashikon, ne kemi të gjithë hapësirën e nevojshme në ligj që të rrimë brenda hapësirës kushtetuese. Mjaft që Kushtetuta të mos e ketë të ndaluar. Në qoftë se e ka përcaktuar qartë, mbi atë kufizim nuk shkon dot.

Fatmir Mediu – Ndoshta më mirë është që ne të mos jemi kaq specifikë te neni kushtetues dhe ta kufizojmë më mirë me ligj, me dakordësi këtu me njëri-tjetrin sesa ta kundërshtojmë në ligj dhe të kemi hapësirë më të vogël për zgjedhje.

Fatmir Xhafaj – Ju falënderoj shumë, zoti Mediu, për shkak se këtë gjë, kam kaq kohë që e kërkoj, edhe pse kemi zhvilluar kaq shumë seanca, madje e kam kërkuar edhe gjatë gjithë kësaj paraditeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ju keni një gjë, kur vjen te një pikë që e mendoni ju, thoni të jetë kështu, kur vini te parimi, te principi, thoni të bëhet dhe kështu dhe ashtu. I qëndroni një principi.

Fatmir Mediu - Do t'ju marr një shembull që e kam preokupant, e kam ngritur edhe në kohën kur ishim në qeveri. Po ju marr një student që mbaron shkollën jashtë Shqipërisë, me një mesatare të konsiderueshme 8, ka mbaruar në një nga shkollat më të mira të jurisprudencës dhe, të marrësh 8 në Francë apo në Angli, nuk ka qenë e mundur të konkurrojë për magistraturën për shkak të kriterit të mesatares, ky është problem jo i vogël. Ky është rast konkret dhe e kam ngritur edhe më parë këtë shqetësim.

Ne nuk kemi bërë edhe njesimin e vlerës. Kemi një mesatare sipas kriterit tonë, por nuk kemi pasur një kategorizim të sistemit tonë arsimor të tillë që të përcaktojë vlerën e asaj që përfiton studenti me diplomën e tij.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, është shumë e rëndësishme që norma kushtetuese të jetë e definuar sa më qartë, dhe sa më pak ngarkesë të ketë, aq më pak telashe do të ketë nesër për hartimin dhe zbatimin e legjislaturës. Të mbetemi te pastërtia e normës kushtetuese, sa më shumë ta rëndojmë, aq më shumë probleme do të ketë në hapat e mëtejshëm.

Dakord me nenin 51. Keni gjë për të shtuar?

Oerd Bylykbashi -Mendojmë që formulimi për Prokurorin e Përgjithshëm të jetë i tillë.

“1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Kuvendi dhe përzgjidhet nga lista e renditjes së kandidatëve, e hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Prokurori i Përgjithshëm emërohet me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 7-vjeçare, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e pesë kandidatëve të renditur më lart në listën e hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave në Kuvend, përsëritet një votim i dytë brenda 7 ditëve nga radhët e dhjetë kandidatëve të kualifikuar më lart. Nëse edhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidati që është renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas meritokracisë, konsiderohet i emëruar.

3. Prokurori i Përgjithshëm duhet të jetë me shtetësi shqiptare dhe përzgjidhet nga radhët e juristëve me aftësitë më të larta profesionale. Ai duhet të ketë njohuri të thella të veprimtarisë publike dhe të ndjekjes penale, si edhe të paktën 13 vjet përvojë të spikatur pune në profesion. Prokurori i Përgjithshëm duhet të gëzojë integritetin më të lartë profesional dhe moral. Ai nuk mund të ketë mbajtur funksione politike në organet publike apo një funksion drejtues në një parti politike gjatë X viteve të fundit përpara kandidimit.

4. Procedura e zgjedhjes dhe emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin krahasimor të përmbushjes së kriterëve, transparencën dhe standardet e tjera të procesit të

rregullt ligjor. Rregullat më të detajuara për vlerësimin e kushteve, të kriterëve, si edhe të procedurave të kandidimit për zgjedhjen dhe emërimin, të përcaktohen me ligj.”

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 51. Vazhdojmë me nenin 52.

Neni 52 “Kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm”. Ekspertët e nivelit të lartë kanë bërë një renditje të kompetencave. Keni ndonjë sugjerim?

Zoti Bylykbashi, ju si e mendoni si opozitë?

Oerd Bylykbashi – Propozimi ynë në lidhje me kompetencat është që Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

“ a)Përfaqëson Prokurorinë në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese...”

Fatmir Xhafaj - ... Si e keni formulimin? Përfaqëson Prokurorinë. Dakord.

Oerd Bylykbashi –“Në vlerësim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Udhëzimet e përgjithshme nxirren për përmirësimin e cilësisë dhe efijencës së veprimtarisë së prokurorisë, për zbatimin e një politike të drejtë penale në luftën kundër kriminalitetit, si edhe për të siguruar zbatimin uniform të ligjit nga prokurori.

c) Kontrollon zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të miratuara prej tij, si edhe zbatimin e politikës penale për luftën ndaj kriminalitetit, me përjashtim të prokurorit të Prokurorisë së Posaçme.

ç) Shqyrton ankesat ndaj prokurorëve dhe kontrollon veprimtarinë e prokurorit të të gjitha niveleve dhe, kur është rasti, paraqet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kërkesën për procedimin disiplinor të tyre, me përjashtim të prokurorit të Prokurorisë së Posaçme.

d) Drejton, kontrollon dhe kujdeset për administrimin e zyrave të prokurorisë dhe për shërbimin e administratës së tyre, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme.

dh) Mbikëqyr trajnimin profesional të administratës së prokurorisë me përjashtim të asaj të Prokurorisë së Posaçme.

e) Propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme.

ë) Raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, duke informuar të paktën një herë në vit publikun dhe Kuvendin edhe për nevojat e organit të prokurorisë.”

f) Ushtron kompetencat e tjera të përcaktuara në ligj.

2. Prokurori i Përgjithshëm nxit efijencën dhe cilësinë e veprimtarisë së prokurorisë, duke bërë planifikime strategjike dhe strukturore të organit të prokurorisë, me përjashtim të

Prokurorisë së Posaçme. Ai merr masa për të forcuar besimin publik të organit të prokurorisë, duke vlerësuar cilësinë e veprimtarisë së prokurorisë, si edhe duke u kërkuar autoriteteve shtetërore kompetente marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë e ndjekjes penale.”

Fatmir Xhafaj – Ka vetëm diçka, duhet të bëni një dallim. Me këtë që propozoni, nuk po i hyj fare teknikës legislative e të tjerave, ajo që kam insistuar shpesh për këtë gjë e që dua të them është se në formulimin tuaj ka tre elemente shumë të rëndësishme.

E para, Prokurori i Përgjithshëm është mbi Këshillin e Prokurorisë. Shikojeni me kujdes dispozitën. Në vlerësimin e hartuesve, edhe timin gjithashtu, ne ndajmë të njëjtin gjykim, që në piramidën e prokurorisë, Këshilli i Prokurorisë është organi më i lartë i sistemit të drejtësisë, që ndihmon që sistemi të vetërregullohet, pra drejtimin e gjithë sistemit në prokurori e ka Këshilli. Nga ai burojnë organet, veprimi, kontrolli, disiplinimi i gjithë sistemi i prokurorisë.

E dyta, ju keni futur në këtë nen “Kontrolli i prokurorit mbi prokurorët e veçantë”, që do të thotë se autoriteti i individit, pra problemi që kemi pranuar të gjithë, qoftë në debatet që bëhen, qoftë në analizat që bëhen, në gjithë tryezat që janë bërë, është që prokurori sot ka një rol të pakufizuar, ka një pushtet vendimmarrës individual të jashtëzakonshëm, që ushtron presion mbi prokurorë të veçantë, dhe ju me këtë formulim (qofsha i gabuar dhe dua ta sqaroni këtë gjë), e konsideroni një organ tejet të centralizuar me kompetenca kontrolluese dhe inspektuese të prokurorit të Përgjithshëm.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, besoj që askush nga ne nuk ka dyshim në lidhje me formulimin që kemi paraqitur ne, që Këshilli i Lartë i Prokurorisë është në majën e tij të kësaj piramide. Ka një ndryshim thelbësor, në qoftë se deri më sot me ligj Prokurori i Përgjithshëm nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e prokurorëve të veçantë, ne e dimë shumë mirë që ka një pushtet, që transferon nga Konispoli të çon në Vermosh ose të pushon, dhe për rrjedhojë, është një lloj dere e prapme për të bërë që prokurori që në dukje është sot, ka autonominë e tij, të mos themi pavarësinë, t’i bindet Prokurorit të Përgjithshëm. Ajo që ne po parashikojmë këtu është mundësia që prokurori që ka lëshuar udhëzime, nga ana tjetër duhet të kontrollojë edhe verifikimin e këtyre udhëzimeve sa ato zbatohen nga prokurorët.

Në qoftë se një Prokuror i Përgjithshëm është deklarativ në udhëzimet që lëshon, dhe prokurorët që janë nën hierarkinë e tij, s’po flasim për prokurorin e posaçëm, nuk i zbatojnë, nuk kuptoj pse duhet parashikimi, atëherë i japim mundësinë që Prokurori i Përgjithshëm inspekton zbatimin dhe më pas, kur ai konstaton që ka gjëra që nuk shkojnë me këtë zbatim të këtyre udhëzimeve, merr dhe çon përpara KLP-së, dhe është ajo që merr masat dhe vendos.

Pra KLP-ja është mbi prokurorin. Këtë gjë ai sot nuk e ka, sepse ai e zgjidh ndryshe, e transferon ose e pushon vetë.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë e ndoqa me vëmendje kolegun Bylykbashi dhe nuk do të doja të përsërisja atë çfarë ju thatë për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm në raport me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Por, nga ana tjetër, m'u krijua përshtypja që me atë model, atë variant, që solli kolegu i opozitës, na solli këtu pjesën e ligjit dhe jo të Kushtetutës.

Mendoj që në Kushtetutë duhet të zgjidhen ose të gjejnë rregullim parimor katër çështje:

E para, raporti i Prokurorit të Përgjithshëm me akuzën, pra duhet të përfaqësojë akuzën në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, apo jo? Mendoj që kjo duhet të jetë në Kushtetutë dhe me të drejtë kolegu Manja e pasqyroj në paragrafin e parë.

Çështja e dytë, që duhet të gjejë zgjidhje eksplicite në Kushtetutë, është raporti i Prokurorit të Përgjithshëm me prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për ndjekje penale, ku duhet përjashtuar e drejta e Prokurorit të Përgjithshëm për të përfaqësuar në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese ato çështje të cilat me ligj apo me Kushtetutë u janë lënë prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.

E treta që duhet të gjejë zgjidhje në Kushtetutë është se a ka të drejtë Prokurori i Përgjithshëm të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për prokurorët? Po! Kjo duhet të jetë në Kushtetutë, por gjithmonë të zgjidhim raportin që jo për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme sepse po shkojmë drejt kufizimit ose përcaktimit të reduksionit të dy prokurorëve, për të cilat kjo lloj ndarjeje dhe qartësie për kompetencat e tyre lëndore, duhet bërë në Kushtetutë. Pa dyshim, në Kushtetutë duhet të jetë edhe detyrimi që ka prokurori që të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit. Kjo është e domosdoshme. Ajo që ne duhet të diskutojmë dhe ndoshta duhet ta kemi pak kujdes, është se kush do të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme, lidhur me gjendjen e kriminalitetit, jo me rastet konkrete. Pra, Kuvendi duhet të ketë një raport edhe për veprimtarinë e prokurorëve të posaçëm. Do të raportojë Prokurori i Përgjithshëm edhe për këta?

Nga mënyra sesi kemi formuluar ligjin, më rezulton që ai nuk raporton dot, sepse Prokuroria e Posaçme ka pavarësi nga prokurori i Përgjithshëm. Do të raportojë Këshilli Lartë i Prokurorëve? Në traditën tonë nuk është kështu. Këshilli i Lartë mund të raportojë për çështje të tjera, por kjo çështje duhet sqaruar.

Gjithashtu, zoti kryetar, në këtë nen për Prokurorin e Përgjithshëm, mbështes kolegun Manja, duhet të ketë një rregullim që Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të administrojë buxhetin e prokurorisë, por jo të Prokurorisë së Posaçme.

Të gjitha kompetencat e tjera që ngriti kolegu Bylykbashi, mund t'i rimbledhim me një formulim të tillë që është aktualisht në Kushtetutë, që ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj dhe të gjitha ato detaje që përmendi zoti Bylykbashi ne mund t'i futim te ligji organik "Për organizimin dhe funksionimin e organit të prokurorisë".

Faleminderit!

Ulsi Manja – Nuk e kam të draftuar propozimin e kolegut Bylykbashi, por nisur nga mënyra si e propozon kolegu, neni 52 bie ndesh me nenin 45 të këtij drafti kushtetues. Ne kemi thënë se cenohet pavarësia e brendshme e prokurorëve për hetimin dhe për ndjekjen penale. Në rast se me këtë parashikim kushtetues në draft synohet një pavarësi e brendshme e prokurorëve për sa i përket hetimit dhe ndjekjes penale, Prokurorin e Përgjithshëm, në raport me hetimin dhe ndjekjen penale, e kemi bërë të barabartë mes të barabartëve, por i japim disa kompetenca kushtetuese për sa i përket menaxhimit të institucionit, buxhetit, mirëadministrimit të tij, të administratës, raportimit të gjendjes së kriminalitetit etj. Respektohet pavarësia e prokurorëve për sa i përket hetimit dhe ndjekjes penale, sepse cila është fryma e draftit të kapitulli për prokurorinë?! Kontrollin e jashtëm ia kemi dhënë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, pra ne kemi futur formën e kontrollit të jashtëm mbi prokurorinë, pra këtë fuqi nuk e ka prokurori i Përgjithshëm. Ajo që kemi synuar me këtë draft është pavarësia e prokurorëve në raport me hetimin dhe ndjekjen penale. T'i japësh kompetenca prokurorit të Përgjithshëm për të nxjerrë urdhra dhe udhëzime në raport me pjesën tjetër të strukturës, do të thotë që bie poshtë parashikimi që keni bërë te neni 45. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi ku gjenerojnë të gjithë, edhe prokurori i Përgjithshëm, edhe Prokuroria e Posaçme. Pra, pa e parë në detaje, ndoshta, një pjesë e propozimeve mund të jenë pjesë e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", por mendoj se duhet të shikohen me seriozitet, sepse një ndërthurje ose një parashikim i tyre te neni 52 mund ta cenonte nenin 45.

Fatmir Xhafaj – Zoti Majko.

Pandeli Majko – Ka një diferencë ndërmjet propozimeve që mbron opozita dhe atyre që kanë bërë kolegët e maxhorancës dhe ajo duhet të identifikohet. Kemi kaluar nenin 47 dhe e bëjmë këtë diferencë. Ne mendojmë se Këshilli i Lartë i Prokurorisë është garanti i pavarësisë së prokurorisë. Nëse do të shprehesh me një gjuhë pak të përgjithshme, do të thosha se, në qoftë se me sistemin aktual Prokurori i Përgjithshëm është një sulltan, ne duam

që Prokurorin e Përgjithshëm ta bëjmë një mbret britanik. Po ta vini re, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është ai që bën emërimet, vendos masat disiplinore, i propozon Kuvendit kandidatin për Prokuror të Përgjithshëm, miraton rregullat e etikës etj., kurse Prokurori i Përgjithshëm, përsëri sipas nenit 52, përfaqëson akuzën, nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim, pra është edhe një administrator i mirë, por pavarësia e Prokurorisë së Përgjithshme nuk është më në duart nominale të një individi. Nuk i heq asnjë presje faktit që ju vini nga një sistem i caktuar dhe nga një eksperiencë e caktuar, që e njeh jurisprudenca, por kthehemi pak në terrenin praktik të Shqipërisë dhe do t'ju bëj një pyetje, që është e hidhur për mua që kam, deri diku, një eksperiencë pak më të madhe bashkë me zotin Mediu dhe me zotin Xhafaj, me thoni një Prokuror të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë që e ka mbyllur mandatin e tij në mënyrën më normale të mundshme nga viti 1991. Të gjithë janë shkarkuar ose janë fyer në atë mënyrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Le ta vazhdojmë bisedën, se po diskutojmë ndryshimet kushtetuese. Mendoj se propozimi, të cilin e kemi diskutuar edhe me Komisionin e Venecias, ka parasysh pikërisht këtë: pavarësia e Prokurorisë së Përgjithshme nuk mund të burojë në mënyrë nominale nga një njeri, më i miri qoftë ai, në kushtet e një tradite juridike dhe politike, siç është vendi ynë. Nuk po bëhet fjalë për ta nënvlerësuar vendin tonë, por për ta parë situatën ashtu siç është. Prandaj, mendoj se ne duhet të bëjmë dallimin që ekziston nga pikëpamja sistemike ndërmjet asaj si e shikoni ju institucionin dhe asaj si e shikojmë ne. Mendojmë se pavarësia duhet të garantohet nga një organ kolegjal, kurse ju mendoni të jeni përsëri me sistemin që Prokurori i Përgjithshëm është ai që të bën më të mirën dhe gjëmën, flas brenda sistemit të prokurorisë. Kjo pastaj hap një diskutim tjetër lidhur me çështjen e korporatizimit. Korporatizmi nuk është gjithmonë një grup individësh, por ushqehet edhe nga mënyrat shumë të centralizuara që ekzistojnë brenda sistemeve tona të brendshme të drejtësisë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – I dëgjova me vëmendje kolegët, Majko dhe Manja. Besoj e lexova mirë, pra Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, përgjegjshmërinë, statusin etj. Pra, nuk po thoni asgjë më shumë se po themi ne. E deshët me zë, u regjistrua me zë që, po, është në krye të gjësë. Ai do ta garantojë të gjithën, por ne këtu fillojmë dhe ndryshojmë edhe në disa aspekte të tjera. Unë nuk mbaj asnjë lloj përgjegjësie për Kushtetutën e vitit 1998. Nuk kam qenë atëherë. E kam lexuar dhe kam pasur vërejtjet e mia dhe një pjesë e madhe e kolegëve të mi këtu. Një vërejtje të madhe që kam pasur, kur lexoja Kushtetutën si jurist i diplomuar, ishte se kjo prokuroria nuk ishte e lidhur askund. Funkciononte pranë

sistemit gjyqësor, por nuk ishte e sistemit gjyqësor; nuk ishte e ekzekutivit, se ishte model tjetër. Mund të thuash se kishte varësi nga Presidenti i Republikës, por në moment i thoshte Presidentit të Republikës “këtu ndahemi bashkë” dhe ishte një minë që lëvizte lirshëm në sistem dhe nuk ishte lidhur askund. Pra, vetëm te ne është model i veçantë. Ishte pikërisht kjo nga arsyet pse ka pasur probleme prokuroria deri më sot. Këtë e interpretonin si pavarësi, por unë nuk e di si mund të ketë pavarësi kur të gjithë ishin të rregulluar, madje Prokurori i Përgjithshëm nuk kishte as mandat. Zoti Majko, ju kujtohet që në vitin 2008 i vumë mandatin 5-vjeçar dhe u duk sikur ishte eureka e historisë së Prokurorit të Përgjithshëm, por ishte një gjë qesharake. Por më shumë se kaq më kujtohet shumë mirë tërbimi që shkaktoi kthimi i fjalës nga “i informon parlamentin” në “i raporton parlamentit”, se dukej sikur ishte cenim i pavarësisë së prokurorisë, i kësaj prokurorie që shkonte në të gjithë sistemin si të donte. Ndërkohë, nuk i kishte prokurori.

Garantimi i pavarësisë është e shkruar e zeza mbi të bardhë dhe duket sikur këtu jemi në të njëjtën pikë. Ecim më tej dhe themi se Prokurori i Përgjithshëm do të zgjidhet me tre të pestat në parlament, pra investohet parlamenti për të zgjedhur dhe do të krijohej edhe një situatë politike: do të vëmë edhe gishtin mbi njëri-tjetrin, pra më the e të thashë për këtë histori. Për çfarë? Për atë që thotë kolegu Manja se një nëndraft kundërshtuaka një nëndraft tjetër. Mua më ngriu zemra mos kundërshtonte ndonjë nen ekzistues të Kushtetutës, por drafti draftin do ta kundërshtojë. Nuk ka ndonjë gjë, sepse do të bëjmë marrëveshje për një nen. Por të investosh kaq shumë, pra Kushtetutën, kushtetutbërësit e çdo gjë tjetër që vjen pas, përfshirë edhe Komisionin e Venecias dhe ekspertët, për çfarë?! Për një që është dhe më pak se një CEO, siç e parashikoni ju, në një sistem kaq të rëndësishëm. Çështjet civile i ndajmë ndoshta edhe pa gjykatë, por kriminelit nuk kemi çfarë t’i bëjmë dhe atij do t’i kërkojmë llogari edhe për mënyrën sesi është luftuar kriminaliteti; ky qenka dikush që është një i barabartë midis të barabartëve, pra *primus inter pares*. Jo! Ne propozojmë diçka tjetër. Po, është e vërtetë që kemi diferencë. Ne mendojmë se kontrollin do ta bëjnë këta nga brenda që të mos ketë kontroll politik mbi ta. Përgjegjshmërinë do ta zgjidhin vetë ata. Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të jetë ai që do ta ndajë nëse kanë shkelur apo jo ligjin prokurorët e sistemit, por do t’i japim dikujt një moment disiplinimi, prapë brenda sistemit do t’ia japim, por nuk vendos. Në qoftë se Prokurori i Përgjithshëm nxjerr sot udhëzime, të heq nga puna, të transferon atje ku nuk ke mundësi të shkosh të punosh, sot këtë nuk e ka, sepse e bën Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Por, në qoftë se nxjerr një udhëzim të përgjithshëm, por nuk do të nxjerrë pamflet, por do të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me qëllime të përcaktuara, për rrjedhojë do të shikojë si po e zbatojnë prokurorët këtë. Një minimum do e bëjë ai. Përsëri,

kur nuk është i bindur, në KLP e çon nuk merr ai vetë masën. Kështu që ndryshimet mund të jenë thelbësore, por nuk do të thotë se ju keni të drejtën në këtë histori dhe nuk e paskemi ne. Kështu që nuk kundërshton drafti draftin. Jemi me dy mendime të ndryshme dhe do të arrijmë në një të përbashkët.

Fatmir Xhafaj – Keni gjë tjetër për këtë? Nuk ka. Kjo do të thotë se neni në tërësi mbetet siç është, me riformulimet që u bënë.

Te neni 53 ka ndonjë gjë?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te neni 53 janë të njëjta sugjerime për redaktim, sikurse në nenet e tjera të ngjashme.

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me nenin 53, bëra një sugjerim më parë që mund të hyjë te përmbledhja për të gjitha rastet e parashikuara në këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull me nenin 53, se nuk kishim gjë.

Neni 54. Nuk ka gjë.

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me nenin 54, formulimi ynë për këtë nen: “Prokurori i Përgjithshëm mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur: dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; kryen shkelje të tjera të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, sipas përcaktimeve të bëra me ligj.

2. Procedimi disiplinor i Prokurorit të Përgjithshëm zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohet me ligj dhe garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor”.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Pandeli Majko - Jam që neni të mbetet ashtu siç është, siç është diskutuar edhe me ekspertët ndërkombëtarë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Dua t’i bëj një pyetje zotit Oerd. Në rast se ju e çoni direkt Prokurorin e Përgjithshëm të ankohet te Gjykata Kushtetuese, të drejtën e ankimit ku do e ketë ai përveç Gjykatës Kushtetuese? Ju e çoni direkt në Gjykatë Kushtetuese, duke shmangur Tribunalin? Ka të drejtë të ankimohet ai kur nuk i është respektuar procesi? Pra, ju i hiqni një hallkë ankimit.

Oerd Bylykbashi – Në qoftë se ka një vend, që është vendi më i duhur për t’u ankuar sesi është respektuar procesi i rregullt ligjor, është Gjykata Kushtetuese.

Ne themi atje dhe zgjidhet përfundimisht. Kemi një procedim për të, i cili shkon dhe zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese. Kjo është zgjidhja jonë, kurse ju e keni tek Tribunali.

Fatmir Xhafaj – Ne kemi kaq vjet që luftojmë që deputetët t'i çojmë në tri shkallë, këta kanë kaq vjet që e mbrojnë me një shkallë.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, ne themi se Tribunali ka prokurorë brenda; do të shqyrtojë edhe prokurorin. Themi se do ta çojmë te Gjykata Kushtetuese, që nuk ka lidhje fare me këtë. I njëjti arsyetim është bërë edhe në rastin gjyqësorit, kështu që nuk po themi ndonjë gjë që nuk është e kuptuar.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

U kuptuam që Tribunali nuk është pjesë e projektit tuaj.

Atëherë, me sa kuptova në të gjithë këtë diskutim që bëmë, për të bërë një përmbledhje, nuk ka gjëra thelbësore që krijojnë diferencë me projektin e paraqitur dhe mbetet për t'i falënderuar ekspertët për punën shumë të mirë që kanë bërë. Natyrisht, ka sugjerime që lidhen me një sistemim më të mirë për të përcaktuar hierarkinë brenda normave në raport me hierarkinë institucionale të sistemit. Janë disa propozime, që lidhen me saktësimin e termave gjyqësorë, disa propozime që lidhen me thjeshtësimin e normës në mënyrë që të jetë më e qartë, më e fokusuar te çështja që duhet të trajtojë, natyrisht, ka edhe disa propozime që vijnë nga opozita, të cilat janë tërësisht të ndryshme me projektin që është paraqitur, por kjo mbetet për t'u parë. Ndërkohë, e mbyllim këtu pjesën e cila ka të bëjë me prokurorinë. Besoj se biem dakord me kolegët e maxhorancës edhe të opozitës. Do të vazhdojmë ditën e premte në orën 10:00.

Po, pra, ka nesër pasdite ka edhe të enjten.

(Zoti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Do të mblidhemi ditën e premte në orën 10:00. Kemi nenin 5, që ka të bëjë me Këshillin e Emërimeve, më pas janë dispozitat kalimtare dhe e fundit, pjesa 18, nga neni 57 deri tek aneksi, që është deri te neni 58. Nuk janë shumë nene, kështu që kemi gjithë mundësinë t'i kalojmë. Janë të gjata, por 4-5 nene janë.

Aneksin do ta mbarojmë në një ditë të vetme. Aneksi do të jetë për ditën e shtunë, që ta mbyllim deri në fundjavë. Zoti Vasili, dakord?

E mbyllim këtu. Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, të shtunën mund të kemi vështirësi për ta bërë mbledhjen, kështu që e diskutojmë nesër dhe mund të biem dakord, por për ditën e shtunë nuk e mbyllim dot. Unë jam gati, po të jetë nevoja...

Fatmir Xhafaj - Faleminderit të gjithëve! Shihemi ditën e premte në orën 10:00!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë